



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 91 Akti

Nr. 95 Vendimi

Tiranë, më 08.01.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Xhensila Pine	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, më datë 04 Janar 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (Ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Alltun Çela**, gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, i cili, pranoi rezultatet e hetimit administrativ dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E, Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (referuar më poshtë “Kushtetuta”).

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit: atë pasuror, atë të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Alltun Çela, ushtron detyrën e gjyqtarit/kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, z. Alltun Çela, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 15.01.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shpërndarë me short çështja konkrete.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.01.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuesi, zonja Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin z. Alltun Çela.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD).

Këto raporte u administruan nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;

- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 24.07.2018, e deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. *** prot., datë 21.09.2018 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar 3 dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 19.04.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 04.12.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, më datë 06.12.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 11.12.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij më datë 24.12.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 27.12.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 04.01.2019, ora 10:00, në adresën: Pallati i Koncerteve (Ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojti personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Alltun Çela, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

i. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;

Në deklaratën “Vetting” **subjekti** deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. **Tokë arë**, ullishte, pemishte, truall, me sipërfaqe të përgjithshme **17.540 m²**, ku janë dhe 51 rrënjë ullinj shumëvjeçar, si dhe agrume dhe pemë frutore. Gjithashtu janë mbjellë dhe 250 rrënjë ullinj dhe pemë frutore në disa parcela.

Burimi i krijimit: Akti i marrjes së tokës në pronësi nr. *** akti, datë 01.07.1994, të dhënë nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, fshati ***, Delvinë, përfutuar nga ligji nr. 7501/1991 “Për tokën”, në bashkëpronësi, për gjashtë vetë: prindërit K. C, F. C, bashkëshortja M. Ç dhe fëmijët M. e I. Ç, në 1/6 pjesë secili të pandarë. Vërtetimi nr. *** prot., datë 13.10.2016 i Njesisë Administrative ***, Delvinë. Të pavlerësuar.

2. **Shtëpi banimi në fshatin ***, Delvinë**, e ndërtuar para vitit 1990, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, faqe *** indeksi, nr. ***, datë 19.6.1996, ZVRPP Sarandë. **Burimi i krijimit:** Kontratë dhurimi nr. *** rep, nr. *** kol, datë 11.6.1996, mbajtur nga noteri A. L, Sarandë, dhuruar nga babai K. Ç. Origjina e pasurisë, banesë e vjetër, sipas vendimit gjyqësor me nr. ***, datë 12.10.1995 i Gjykatës së Rrethit Delvinë. E pavlerësuar. Zotërimi 100%.

3. **Shtëpi banimi në ish-objektin “****”, Sarandë**, ndërtuar para viteve 1990, lagjja nr. ***, godina nr. ***, me sipërfaqe objekti **48.9 m²**, kati parë i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, faqe ***, nr. *** indeksi, datë 21.4.1996. Përshtatur për banim në vitin 1994 - 1995. Shpenzimet për përshtatje për banim, nga të ardhura e kursime, gjatë këtyre viteve.

Burimi i krijimit: Kontratë shitblerje me nr. ***, datë 14.2.1995, çmimi i blerjes **1.107.000 lekë**; në bashkëpronësi në 1/10 pjesë, ish-objekti “***” Sarandë, me sipërfaqe në bashkëpronësi 903 m², tek noteri A. L, Sarandë. Kontratë pjesëtimi nr. ***, datë 29.12.1995, noteri A. A, Sarandë. Vlera e pasurisë **110.700 lekë**. Zotërimi 100%.

4. Shtesë e katit, e ndërtuar mbi banesën ekzistuese, e përshkruar në pikën 3, me sipërfaqe 110 m², godina nr. 20, Sarandë.

Burimi i krijimit: Leje ndërtimi “Rikonstruksion banese”, të dhënë me vendimin e KRRT-së, Bashkia Sarandë, nr. ***, datë 18.4.2002 për 8 bashkëpronarët e objektit.

Shpenzimet e kryera në vitin 2002 sipas preventivit dhe lejes së ndërtimit për 8 bashkëpronarët ka qenë 6.764.083 lekë = **845.510 lekë** për secilin.

Shpenzime të kryera brenda shtesës së katit në vitin 2004 kanë qenë në shumë **595.400 lekë**, sipas preventivit.

Shpenzimet për ndërtimin e shtesës së katit në vitin 2002 dhe ato të kryera në vitin 2004, janë kryer nga lekët e dhëna me prokurën e posaçme nr. *** rep, datë 18.8.2000, tek noteri A. A Sarandë, nga prindërit K. e F. Ç., si dhe kursime të këtyre viteve.

Me vendimin gjyqësor me nr. 23-2013-1702, datë 25.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është njohur shtesa e katit të ndërtuar mbi banesën ekzistuese pas rikonstruksionit, për efekt regjistrimi, (shkresa me nr. *** prot., datë 11.10.2016 të ZVRPP-së Sarandë) në proces regjistrimi pranë ZVRPP-së Sarandë. Vlera e pasurisë **1.440.910 lekë**. Zotërimi 100%.

5. Ambient magazinë, e ndërtuar para viteve 1990, përshtatur për banim, kati përdhe, poshtë banesës ekzistuese e përshkruar në pikën 3, me sipërfaqe. 51 m², lagjja nr. *, Sarandë, regjistruar në zonën kadastrale nr. ***, me nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, rr. “***”, Sarandë.**

Burimi i krijimit: Kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 17.8.2002, tek noteri G. N, me shitës S. K dhe blerës Alltun Çela e M. N. Çmimi i blerjes **1.000.000 (një milion lekë)** në 1/2 pjesë secili. Me kontratën e pjesëtimin nr. ***, datë 21.10.2016 të mbajtur nga noteri E. M, është bërë pjesëtimi në 1/2 pjesë.

Shpenzimet brenda ambientit, sipas kontratës së pjesëtimin datë 10.09.2002, vërtetuar tek noteri Th. K, nr. ***, datë 6.1.2003, janë në 1/2 pjesë secili, në shumën **510.967 lekë**, sipas preventivit.

Shpenzimet për blerjen dhe rregullimet brenda ambientit janë nga të ardhurat nga kursimet dhe qiratë.

Të pesta pasuritë e mësipërme janë pasqyruar në shkresën me nr. *** prot., datë 11.10.2016, të ZRPP-së Sarandë. Vlera e pasurisë **755.484 lekë**. Zotërimi 100%.

6. Truall, 400 m², parcela nr. *, blloku *** Sarandë.**

Burimi i krijimit: Përfitur me vendimin nr. ***, datë 28.8.1999 të Këshillit të Bashkisë Sarandë, i papaguar, pa kontratë shitblerje, pa regjistruar në ZVRPP. Vlera e pasurisë **5000 lekë**. Zotërimi 100%.

7. Ambient, me sipërfaqe 30 m², lagjja nr. 1, Sarandë, kati i dytë, e pamobiluar.

Burimi i krijimit: Kontrata e sipërmarrjes me nr. ***, datë 31.2.2011, tek noterja L. T, Sarandë. Paguar me këste. Likuiduar në vitin 2013, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 27.12.2016, tek noteri A. A, Sarandë. Pa kontratë shitblerje, e paregjistruar në ZVRPP.

Blerë me kursimet gjatë këtyre viteve. Vlera e pasurisë **1.200.000 lekë**. Zotërimi 100%.

8. Apartament banimi, *, Tiranë,** në zonën kadastrale nr. ***, pasurie ***, vol. ***, faqe ***, me sipërfaqe 102,3 m². Regjistruar në ZVRPP-në Tiranë zona kadastrale ***, nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, ***, Tiranë. Blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.3.2013, të noteres A. H, Tiranë.

Burimi i krijimit: Kontrata e kredisë bankare datë 12.2.2013, të lidhur me Raiffeisen Bank Sh.a, në shumën: 2.817.900 lekë.

Kontratë huaje me nr. ***, datë 13.2.2013, tek noteri F. Q, Sarandë, me shtetasin F. L, Sarandë, në shumën 3.500.000 lekë.

1.182.100 lekë, kursime të deklaruara nga deklaratat e mëparshme. Vlera e pasurisë **7.500.000 lekë**. Zotërimi 100%.

9. Garazh makine, *, Tiranë,** në zonën kadastrale ***, nr. pasurie ***, vol. ***, faqe *** me sipërfaqe 22 m², regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, datë 25.3.2013, pasuri garazh, regjistruar në z.k ***, nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, ***, Tiranë. Blerë me të njëjtën kontratë që është blerë apartamenti i banimit, kontratën e shitblerjes nr. *** rep, nr. *** kol, datë 7.3.2013, të noteres A. H Tiranë.

Burimi i krijimit: Me një pjesë të kursimeve, vlera e pasurisë **500.000 lekë**. Zotërimi 100%.

10. Automjet tip Golf, blerë nga shtetasi S. N. Gj, në shumën **520.000 lekë**, me kontratë shitblerje nr. ***, datë 09.08.1998, tek noteri B. M. Durrës.

Burimi i krijimit: Kursimet dhe të ardhurat.

Automjeti është shitur në shumën **250.000 lekë**, më kontratën për shitblerje mjete nr. ***, datë 13.6.2003, tek noteri A. A. Sarandë. (i shitur)

11. Automjet tip Benz 124 (200D), e vitit 1994, blerë nga shtetasi S. H. H, Tiranë, në shumën **250.000 lekë**, me kontratë shitblerje me nr. ***, datë 14.6.2003, tek noteri B. S, Tiranë.

Burimi i krijimit: Të ardhurat e shitjes së makinës Golf në vitin 2003.

Automjeti është shitur në shumën **600.000 lekë**, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.8.2009, tek noteri F. Q, tek shtetasi M. R dhe A. R, fshati *** Delvinë. (i shitur)

12. Automjet i tipit Land Rover i vitit 1999, me naftë, manual, blerë me kontratë shitblerje nr. ***, datë 18.6.2010, tek notere Sh. Gj, Tiranë, nga shtetasi B. N, me çmimi i blerjes **2.000 euro**. Vërtetim zhdoganimi, pagim dogane pranë Raiffeisen Bank, më datë 25.7.2010, nr. reference ***, pagesa 338.586 lekë.

Burimi i krijimit: Të ardhurat e kursyera gjatë viteve. Zotërimi 100%.

13. Automjet i tipit Benz 250, targa ***, e vitit 1992, blerë në shumën **125.000 lekë**, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 18.5.2011, me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Burimi i krijimit: Të ardhurat e kursyera gjatë vitit.

Automjeti është shitur në shumën **220.000 lekë**, me kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. ***, datë 26.4.2013, të noterit F. Q, Sarandë, tek shtetasi A. L, Sarandë. (i shitur).

14. Gjendje cash jashtë sistemit bankar, kursime nga të ardhurat familjare gjatë vitit 2015 - 2016. **800.000 lekë**. Zotërimi 100%.

Deklarim i znj. M. Ç (bashkëshortja e subjektit)

Depozitë bankare në Raiffeisen Bank me nr. *** llogarie, në shumën **3.276.800 lekë**. Kjo depozitë është krijuar në datë 12.2.2013 nga bashkimi i depozitës me nr. *** dhe nr. ***, sipas vërtetimit datë 04.01.2017 të Raiffeisen Bank.

Burimi i krijimit: “Kursime të krijuara para viteve 2001, të depozituara në ish-Bankën e Kursimeve Sarandë, me nr. ***, datë 19.1.2001, kaluar tek Raiffeisen Bank në datë 09.04.2003, depozita ka qenë **1.325.594** (një milion e treqind e njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë. Në vitin 2003 ka qenë dhe depozita prej **1002 euro** pranë Raiffeisen Bank.

Kjo depozitë është krijuar nga kursimet e kohës dhe një pjesë nga shitja e letrës me vlerë në vitin 1994 e dhënë pjesërisht me hua.

Shtim i depozitës bankare datë 24.5.2007, tek Raiffeisen Bank, rrjedh nga depozita e vjehrrës, F. Ç, në shumën 352.118 lekë, në llogarinë time, duke u paraqitur vetë personalisht në bankë.

Depozita bankare vendosur në datë 24.8.2009 tek Raiffeisen Bank, në shumën **1.055.537 lekë**, dhe në datë 19.6.2009, në shumën **2.000 euro**, janë krijuar me kursimet gjatë vitit dhe shitjen e makinës Benz në shumën **600.000 lekë** në vitin 2009.

Depozita prej **3.276.800 lekë** me nr. 0014274245 është vendosur në fondin e investimeve si garanci bankare me kontratën e kredisë datë 12.2.2013, transferuar tek kontrata 22.2.2016 në Raiffeisen Bank, ku është dhe depozita prej 209 lekë, në nr. 0001274245 të llogarisë ka ngelur dhe shuma prej **1839 lekë**. Kjo depozitë është bashkëshortore, e pandarë. Zotërimi 100%.”

Deklarim i znj. M. Ç (vajza e subjektit)

1. Depozitë bankare pranë Raiffeisen Bank, me nr. *** llogarie, sipas vërtetimit datë 04.01.2017, e hapur në vitin 2012.

Burimi i krijimit: “Depozita është krijuar nga kursimet që më ka mbledhur **tezja ime Z. Z** nga viti 2007 - 2012 që kam qenë me studime në Universitetin e Perugias, Itali, në shumën **10.000 euro**. Të gjitha shpenzimet në Itali për qëndrim dhe studim, m’i ka përballuar ajo, sipas deklaratës noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.08.2006, noter G. N. Kam kryer punë me orë të pjeshme sipas deklaratës së shtetasit italian (*shih dokumentet bashkëngjitur*). Një pjesë e kursimeve janë dhe nga bursa mbi 3000 euro në vit. Kursimet i mbante tezja, Z. Z; m’i ka dërguar me gjyshin në vitin 2012 kur edhe kam çelur depozitën. 5000 euro ia kalova në llogari më vete motrës I. Ç.

2. Automjet tip Ford, viti i prodhimit 2001, të cilin e kisha në bashkëpronësi me vëllain tim, E. Ç. Burimi i krijimit: Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.07.2014, tek noteri F. Q, me shitës O. B, në shumën **1000 euro**, në bashkëpronësi me vëllain E. C.

Burimi i krijimit: Nga kursimet e prindërve. Automjeti është shitur me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.6.2016, mbajtur nga noteri F. Q, tek shtetasi S. A, Sarandë, në shumën 100.000 lekë, 1/2 pjesë.

3. Automjet tip Benz, A class, viti i prodhimit 1999. Burimi i krijimit. Kontratë blerje datë 13.11.2014, Letten 11-85307, Panzhau Fereisen, Gjermani, çmimi **800 euro**. Pagesë zhdoganimi datë 17.11.2014, dogana Sarandë, në shumën **34.160 lekë**. Certifikatë pronësie mjetit datë 18.11.2014, targa ***.

Burimi i krijimit: Blerë nga kursimet e vitit të prindërve.

4. Llogari bankare e pagës sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 6.1.2017, tek Credins Bank, është gjendje pa tërhequr, në shumën **306.000 lekë**. **Burimi i krijimit:** i padeklaruar.”

Deklarim i znj. I. Ç (vajza e subjektit)

Depozitë bankare tek Raiffeisen Bank, sipas vërtetimit datë 4.1.2016, me nr. *** llogarie.

Burimi i krijimit: “Dhuruar nga motra ime M. Ç, (shih deklarimin e M. Ç), nga kursimet që ka qenë me studime në Itali, të cilat i kam depozituar në bankë në vitin 2012. Vlera **5160 euro**.”

Deklarim i z. E. Ç (djali i subjektit)

1. Automjet tip Ford, Viti i prodhimit 2001, në bashkëpronësi me motrën M. Ç. Burimi i krijimit: Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. ***kol, datë 07.07.2014, tek noteri F. Q Sarandë, me shitës O. B, në shumën **1000 euro** në bashkëpronësi me motrën M. Çela ½ pjesë.

Burimi i krijimit: “Blerë nga kursimet e prindërve. Automjeti është shitur me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 08.06.2016, mbajtur nga noteri F. Q, tek shtetasi S. A, Sarandë, në shumën **100.000 lekë**.”

Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe atë të rivlerësimit kalimtar (deklarata “Vetting”), të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara në këtë dosje, si edhe të dhënave të përfituara dhe verifikimeve të bëra gjatë hetimit administrativ, u konstatuan probleme të shumta, por Komisioni vendosi të përqëndrojë hetimin dhe rezultatet e tij mbi çështjet si më poshtë:

- 1. Tokë arë**, ullishte, pemishte, truall, me sipërfaqe të përgjithshme **17.540 m²**, ku janë dhe 51 rrënjë ullinj shumëvjeçar, si dhe agrume dhe pemë frutore. Gjithashtu janë mbjellë dhe 250 rrënjë ullinj dhe pemë frutore në disa parcela.

Burimi i krijimit: Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP) nr. *** akti, datë 01.07.1994, të dhënë nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, fshati ***, Delvinë, përfituar nga ligji nr. 7501/1991 “Për tokën”, në bashkëpronësi, për gjashtë vetë: prindërit K. C, F. C, bashkëshortja M. Ç dhe fëmijët M. e I. Ç, në 1/6 pjesë secili të pandarë. Vërtetimi nr. *** prot, datë 13.10.2016 i Njësisë Administrative ***, Delvinë. Të pavlerësuar.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. *** + vërtetim komune, datë 3.2.2010 + vërtetim fotokopje nr. *** + vërtetim nr. ***, nga Bashkia Delvinë, ku vërteton se Alltun Çela ka përfituar tokë nga ligji nr. 7501, në bazë të aktit të marrjes së tokës së fshatit ***, në sasinë 17,540 m².

Arsyetimi ligjor:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se subjekti Alltun Çela, me cilësinë e kryefamiljarit për 6 persona është pajisur me AMTP-në nr. ***, datë 01.09.1994.

Në ligjin nr.7501 “Për tokën” ligjvënësi ka përcaktuar subjektet që përfitojnë nga zbatimi i këtij ligji.

Konkretisht në nenin 5 të tij thuhet se: “*Pajisen me tokë si pas këtij ligji: familjet anëtare të kooperativës bujqësore, ... duke marrë në pronësi tokën bujqësore që u takon nga tërësia e*

subjektit ku bëjnë pjesë. Sasia dhe vendi ku do të jepet toka, përcaktohet nga komisioni i tokës... ”.

Gjithashtu në nenin 6 të këtij ligji thuhet se: *“Familjeve me banim në fshat, që nuk janë anëtarë të kooperativës bujqësore dhe familjeve që punojnë e banojnë në ndërmarrjet bujqësore, u jepet në përdorim tokë bujqësore, madhësia e se cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, VKM-ja nr. 255, datë 02.08.1991, ka përcaktuar kriteret e ndarjes së tokës bujqësore.

Në pikës 1/1 të këtij vendimi përcaktohet se: *“Toka ndahet sipas gjendjes aktuale të sipërfaqeërfaqes që ka kooperativa bujqësore dhe numri i frymëve”.*

Në pikën 2/1 të po këtij vendimi është përcaktuar se: *“Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 01.08.1991”.*

Referuar shkresës nr. ***, datë 01.11.2018 të Njesisë Administrative ***, Bashkia Delvinë, rezulton se në datën 01.08.1991, familja e z. Alltun Çela ka qenë 4 persona, ndërsa familja e z. K. Ç ka qenë 2 persona.

Referuar ligjit nr. 7501, AMTP-ja duhej të kishte dalë në emër të z. K. Ç, me cilësinë e kryefamiljarit (babai i subjektit).

Nga shqyrtimi i mëtejshëm i dokumentacionit rezulton se me vendimin nr. ***, datë 16.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për të ndjerin K. Çela. Ky vendim është marrë nga gjyqtarja N. H., ish-gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Delvinë në të njëjtën kohë me subjektin. Në kohën e dhënies së këtij vendimi gjyqësor, subjekti ushtron detyrën e gjyqtarit në të njëjtën gjykatë. Sipas këtij vendimi, pasuria e të ndjerit K. Ç ndahet në pjesë të barabarta ndërmjet të gjithë fëmijëve të tij, përkatësisht në 6 pjesë. Në këto kushte, pjesa takuese e të ndjerit nga pasuria e paluajtshme e përfituar me AMTP-në, do të duhej të ishte ndarë në 6 pjesë të barabarta, ndërkohë që subjekti të gjithë këtë pasuri e ka deklaruar në pronësinë e tij.

Në përgjigjen e tij të datës 06.11.2018, subjekti sqaron se nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në momentin e përfitimit të kësaj pasurie. Ky fakt është i vërtetë, por nga ky AMTP ka origjinën shtëpia në ***, e përfituar nga subjekti me anë të kontratës së dhurimit (shiko pikën 2 më poshtë).

Nëpërmjet kësaj AMTP-je subjekti ka përfituar edhe “shtëpi”, truall, me sipërfaqe 500 m² në fshatin ***, Njësia Administrative ***, Sarandë. Ndërkohë në dokumentacionin shoqëruar të paraqitur nga vetë subjekti, përkatësisht vërtetim i Njesisë Administrative *** të Bashkisë Delvinë me nr. *** prot., datë 13.10.2016, rezulton se subjekti ka përfituar nëpërmjet AMTP-së “shtëpi”, truall, me sipërfaqe 600 m².

Komisioni ka konstatuar se nuk përputhet sipërfaqja e pasurisë “shtëpi”, truall, të përfituar me AMTP dhe vërtetimit të Njesisë Administrative ***.

Subjektit iu kalua barra e provës për të shpjeguar këtë mospërputhje midis dokumenteve të depozituar nga ai vetë.

Në parashtrimet e tij, si dhe në seancë dëgjimore, subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me këtë mospërputhje. Ai është përqëndruar në sqarimin e procedurës së marrjes së AMTP-së. Sipas tij: *“Në bazë të regjistrit të gjendjes civile të datës 01.08.1991, kryefamiljarë kemi qenë të dy, unë dhe babai. Për shkak të moshës që kishin prindërit në atë periudhë, në mënyrë*

të heshtur kanë dhënë në formën e dhurimit kalimin e pjesës së tyre të tokës në AMTP në emrin tim.”

Në bazë të Kodit Civil¹ të kohës, dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm. Nga ana tjetër, subjekti ka pretenduar se: “Në bazë të ligjit nr. 7501 nuk mund të ndahej truall. Komisioni ka vepruar gabim që ka ndarë këtë truall dhe unë nuk mund ta regjistroja pronën e babait në hipotekë me AMTP truall.” Më tej subjekti sqaron se: “Kjo pronë, prej krijimit, ka pasur dhe ka 100 m² ndërtesë dhe 500 m² truall, sipërfaqe funksionale rreth shtëpisë, gjithsej 600 m². Shtëpia dhe trualli që babai më ka dhuruar janë pasuri trashëgimore dhe jo pasuri të fituara nga ligji nr. 7501.”

Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim përse AMTP-ja është shprehur për shtëpi (truall) 500 m², kur gjendja faktike ka qenë 600 m² (100 m² + 500 m²). Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim apo provë se nga i ka trashëguar babai i tij këto 600 m², siç është shprehur ai në shpjegimet e tij përfundimtare, me shkrim, faqja 4.

Pasi shqyrtoi provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se:

- Subjekti nuk ka arritur të japë sqarim bindës apo të paraqesë prova në lidhje me: a) mospërputhjen e sipërfaqes së pasurisë shtëpi+truall të përfituar me AMTP dhe b) si përfitoi truallin me sipërfaqe 600 m² sipas vërtetimit të Njësisë Administrative *** të datës 13.10.2016

2. Shtëpi banimi në fshatin * Delvinë**, e ndërtuar para vitit 1990, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, faqe *** indeksi, nr. ***, datë 19.6.1996, ZVRPP Sarandë.

Burimi i krijimit: Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.6.1996, mbajtur nga noteri A. L, Sarandë, dhuruar nga babai K. Ç. Origjina e pasurisë: banesë e vjetër, sipas vendimit gjyqësor me nr. ***, datë 12.10.1995 të Gjykatës së Rrethit Delvinë. E pavlerësuar. Zotërimi 100%.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Shkresë “Kthim përgjigje” nr. ***, datë 11.10.2016, nga ZVRPP-ja Sarandë, e cila konfirmon se subjekti ka të regjistruar në ZVRPP-në Sarandë: shtëpi banimi dhe truall me sipërfaqe **600 m²**, në fshatin ***.
- Vendim gjykate nr. ***, datë 12.10.1995, ku një pronar të pasurisë, shtëpi banimi, fshati *** dhe truall 600 m², paditësin z. K. Ç, i cili ka paditur Komunën ***.
- Kontratë dhurimi nr. ***, datë 11.6.1996, dhurues K. Ç (babai) dhe pranues Alltun Çela.

Arsyetimi ligjor:

Subjekti është bërë pronar i shtëpi banimi dhe truall me anë të kontratës së dhurimit nga i ati, K. Ç. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se z. K. Ç i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë më datë 06.10.1995 me cilësinë e paditësit. Duhet të theksohet se subjekti punonte në atë kohë gjyqtar në të njëjtën gjykatë. Palë e paditur është Komuna ***. Objekti i kësaj padie është: “Njohje pronësie mbi një shtëpi banimi, të ndërtuar nga unë, në fshatin ***, me një sipërfaqe trualli prej 600 m², konform nenit 86 të K.Pr. Civile.”

¹ Neni 304 i ligjit nr. 6340, datë 26.06.1981

Në përfundim të arsyetimit, trupi gjykues, bazuar në nenet 86² dhe 155³ të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur njohjen e pronësisë së paditësit K. Ç mbi shtëpinë e banimit të ndërtuar prej tij, në fshatin ***, të rrethit Delvinë, në një sipërfaqe trualli prej 600 m².

Subjekti është pyetur në lidhje me rikonstrukcionin e kësaj banese. Në përgjigjen e tij të datës 06.11.2018 ai sqaron se nuk ka bërë asnjë rikonstrukcion gjatë 5 viteve të fundit, duke bashkëlidhur edhe foto të kësaj banese, para vitit 2013 dhe të vitit 2018, brenda dhe jashtë banesës për të provuar se nuk ka asnjë rikonstrukcion. Nga verifikimi i deklaratave të pasurisë ndër vite konstatohet se për këtë banesë subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë shpenzime. Nga fotot e depozituara nga vetë subjekti nuk arrihet në konkluzionin se kësaj banese nuk i është bërë asnjë përmirësim/rikonstrukcion.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, Komisioni ka konstatuar se:

- Kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Delvinë në datën 06.10.1995;
- Gjykata është shprehur me vendim pas 6 ditësh, më datë 12.10.1995;
- Z. Alltun Çela ka filluar të ushtrojë detyrën e kryetarit/gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Delvinë më datë 31.03.1995. Pra, në kohën e shqyrtimit dhe dhënies së këtij vendimi gjyqësor në favor të babait të tij, subjekti ushtronte detyrën si kryetar i kësaj gjykate;⁴
- Më datë 11.06.1996, z. K. Çela ia dhuron këtë shtëpi të birit, z. Allun Çela;
- Kjo pronë regjistrohet në ZVRPP-në Sarandë më datë 19.06.1996, pas 7 ditësh nga dhurimi.

Nga hetimi ka rezultuar se:

- i. Është i paqartë fakti se si është fituar pronësia mbi truallin prej 600 m², ndërsa gjykata është shprehur për njohjen e pronësisë mbi shtëpinë e banimit mbi këtë truall, pa përcaktuar sipërfaqen e kësaj shtëpie dhe raportin me truallin;
- ii. Është i paqartë fakti nëse kjo sipërfaqe trualli prej 600 m² përputhet me shtëpinë (truall) prej 500 m² të përfituar nga AMTP-ja. Nisur nga vetëdeklarimi “Vetting” i subjektit, supozohet se kemi të bëjmë me të njëjtën pasuri;
- iii. Bazuar në AMTP-në, kjo pronë është përfituar nga vetë subjekti me cilësinë e kryefamiljarit, për pasojë nuk legjitimohet kërkesa e babait të subjektit për njohje pronësie. Kjo kërkesë duhej të ishte paraqitur nga vetë subjekti, me cilësinë e mbajtësit të AMTP-së, ndërkohë që ai punonte si gjyqtar në këtë gjykatë që është shprehur me vendim;
- iv. Është fakt që subjekti ushtronte detyrën e gjyqtarit/kryetarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Delvinë dhe se kjo gjykatë ka marrë në shqyrtim një kërkesë për njohje pronësie të babait të subjektit. Në këtë kohë kjo gjykatë ka patur në përbërje të saj vetëm 4 gjyqtarë dhe 4 ndihmësgjyqtarë;
- v. Fotot e kësaj shtëpie, të depozituara nga subjekti, nuk të krijojnë mundësinë për t'u bindur se kjo banesë nuk është rikonstruktuar të paktën që nga viti 2003.

Subjekti, pasi iu kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit 84/2016, paraqiti provat dhe shpjegimet e tij në lidhje me këto rezultate hetimit.

i. Në lidhje me sipërfaqen e shtëpisë dhe truallit në funksion të saj, subjekti nuk ka sqaruar më shumë sesa shpjegimet e përshkruara më sipër, në pikën 1. Sipas tij, sipërfaqja e ndërtimit është e përcaktuar në genplanin e shtëpisë, të punuar në vitin 17.09.1995 nga specialisti D.L dhe i firmosur nga përgjegjësi i Urbanistikës Ligjore Delvinë, N.Ç. Nga ky genplan rezulton

² Ligji nr. 6343/1981.

³ Ligji nr. 6343/1981, ndryshuar me ligjin nr. 7537/1991.

⁴ Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 24.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, dokumenti i depozituar nga vetë subjekti.

se ka qenë 100 m² banesë dhe 500 m² truall. Subjekti ka pretenduar se: *“Mospërcaktimi në vendimin gjyqësor është jo për fajin tim.”* Me gjithë shpjegimet e subjektit, për Komisionin mbetet e paqartë se si shtëpia e përcaktuar prej 500 m² në AMTP, u regjistrua me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë me sipërfaqen prej 600 m².

ii. Për shkak të kësaj paqartësie, Komisioni ka ngritur dyshime nëse bëhet fjalë për të njëjtën pasuri. Për këtë subjekti është shprehur se: *“Sipërfaqe truall prej 600 m² (100 m² sipërfaqe. e banesës dhe 500 m² truall) është e njëjta sipërfaqe me shtëpinë (truall) prej 500 m² të pasqyruar në AMTP. Ndryshimi i sipërfaqeve vjen për shkak se në AMTP-në është përcaktuar vetëm sipërfaqja truall dhe jo sipërfaqja e truallit që zë banesa. Kjo pasaktësi ka ardhur nga mospasqyrimi i saktë në vendimin gjyqësor i sipërfaqes së ndërtimit dhe të truallit më vete, por është shprehur në total.”*

Në fakt, nga verifikimi i AMTP-së, rezulton se në rreshtin e fundit të saj, pasqyrohet si pasuri “shtëpi”.

iii. Komisioni, bazuar në këtë AMTP, mbajtës i të cilit është vetë subjekti, i ka kaluar këtij të fundit barrën e provës për të provuar legjitimitimin e babait të tij për t’iu drejtuar Gjykatës së Rrethit Delvinë për të njohur pronësinë mbi këtë shtëpi banimi në truallin prej 600 m².

Në arsyetimin e tij, subjekti ka shpjeguar se: *“Në bazë të ligjit 7501 “Për tokën” të vitit 1991, në nenin 3 thuhet se: “Toka bujqësore u jepet në pronësi ose në përdorim personave juridikë a fizikë vendas pa shpërblim”. Objekt i ndarjes së tokës nga komisioni ka qenë toka bujqësore, dhe jo trualli. Sipërfaqja truall 500 m², nuk ka qenë objekt i ndarjes së këtij ligji, e për pasojë unë nuk kisha tagrin e pronarit edhe pse kjo sipërfaqeërfaqe ishte pasqyruar në AMTP. Ky pasqyrim i komisionit për sipërfaqen 500 m² truall në AMTP nuk është i vlefshëm...[...]. Vetëm babai legjitimohej për të ngritur kërkesëpadi për njohjen e pronësisë, pasi unë nuk legjitimohesha për shkak se pronësia për sipërfaqen 500 m² tek AMTP, është i pavlefshëm.”*

Më tej subjekti ka shpjeguar se: *“Vendimi gjyqësor ishte e vetmja mundësi që të regjistrohej kjo pasuri e trashëguar dhe më pas babai të kryente aktin e dhurimit me qëllim plotësimin e dëshirës së tij për pasurinë e trashëguar.”*

Komisioni konstaton se në shpjegimet e tij me shkrim, faqja 4 dhe 5, por edhe ato në seancë, subjekti e konsideron këtë shtëpi në *** si një pasuri të trashëguar të të atit. *“Kjo është shtëpi historike e ndërtuar në breza nga struktura e familjes time. Këtu nuk kemi fitim prone, por vetëm një formalitet teknik, juridik dhe ekonomik të pronës të trashëguar dhe për më tepër nuk kemi përdorim të burimeve financiare.”*, - pretendon subjekti.

Këto shpjegime Komisioni i konsideron të rreme. Këtë konkluzion Komisioni e nxjerr bazuar në arsyetimin e vendimit nr. ***, datë 12.10.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë, sipas të cilit, gjatë hetimit gjyqësor të çështjes civile, u provua se qytetari K. Ç ka ndërtuar me forcat e tij një shtëpi banimi në fshatin ***, që prej vitit 1956. Po sipas këtij vendimi konstatohet se: *“Paditësi K.Ç. shtëpinë në fjalë e ka ndërtuar konform rregullave, me leje të organeve shtetërore të asaj kohe, pas daljes nga burgu, mbasi para burgosjes së tij nuk ka patur shtëpi.”*

iv. Vendimi gjyqësor nr. *** është marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë më datë 12.10.1995, ndërkohë që subjekti ka filluar të ushtrojë detyrën e kryetarit të kësaj gjykate më 31.03.1995. Në lidhje me këtë rezultat hetimi, subjekti ka sqaruar se: *“Referuar bazës ligjore të kohës pavarësisht se unë isha në detyrën e drejtuesit të gjykatës nuk kishte pengesë ligjore që babai im të mos ushtronte një të drejtë në gjykatë. Sipas dispozitave të mësipërme,*

kompetente ishte vetëm Gjykata e Rrethit Delvinë.” Në shpjegimet e tij, subjekti ka dhënë edhe referenca nga ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”⁵.

Komisioni, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve, ka konstatuar se subjekti, megjithëse ushtron funksionin e gjyqtarit pa ndërprerje, që prej muajit mars të vitit 1995, për të arsyetuar marrëdhëniet juridike të ndodhura në vitin 1995, i referohet legjislacionit të vitit 1996.

Në këto kushte, duke qenë se subjekti ka dhënë shpjegime të ndryshme nga sa ka arsyetuar gjykata në lidhje me mënyrën e posedimit të shtëpisë nga i ati, si dhe arsyeton konfliktin e mundshëm të interesit në vitin 1995 me një ligj që ka hyrë në fuqi në vitin 1996, Komisioni nuk arrin të krijojë bindjen për sa pretendon subjekti.

Komisioni, gjithashtu, vlerëson se padyshim që babai i subjektit legjitimohej për të ngritur një padi në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Delvinë, por ishte detyra e të birit si gjyqtar në të njëjtën gjykatë, të merrte masat e duhura për të shmangur një konflikt interesi të mundshëm.

v. Në lidhje me rikonstrukcionin e kësaj banese, subjekti ka shpjeguar, duke depozituar edhe fotografi, se: *“Në banesë, siç shihet qartë dhe nga fotot nuk janë kryer punime rikonstrukcioni por meremete, punime, të cilat janë kryer nga ana ime ndër vite para vitit 2003 e në vazhdim, për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi. Shuma e shpenzimeve është e papërfillshme, pasi kam blerë vetëm materialin. Punimet e mirëmbajtjes nuk janë kryer vetëm në një vit, por gjatë gjithë kohës ndër vite.”* Më tej, në seancën dëgjimore, subjekti ka vijuar shpjegimet: *“Nuk është se unë banoj në ***, në atë fshat. Unë vete për shkak të historisë, të dhembshurisë që kam për fshatin, vete një herë në muaj, një herë në tre muaj. Kështu që nuk është se është bërë ndonjë shpenzim i madh, shpenzime minimale.”*

Pasi dëgjoi subjektin në seancë, shqyrtoi provat dhe shpjegimet e tij të paraqitura me shkrim, Komisioni, megjithëse pamjet e fotografuara nuk janë shumë të qarta, i pranon këto shpjegime të subjektit, pasi nuk sheh prova të kundërta.

Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioni konkludon se:

- ➔ Mbetet ende e paqartë se si shtëpia + truall e pasqyruar në AMTP me sipërfaqe 500 m², u regjistrua me vendim gjykate me sipërfaqe 600 m², pra, 100 m² më shumë;
- ➔ Subjekti ka kryer deklaram të rremë përpara Komisionit për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga babai i subjektit, duke e konsideruar këtë shtëpi si trashëgimi, gjë që bie ndesh me vendimin nr. ***, datë 12.10.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Delvinë;
- ➔ Subjekti nuk arriti të bindë Komisionin se Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Delvinë, kryetar i së cilës ishte vetë subjekti, ishte e vetmja gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës së babait të subjektit për njohjen pronar të shtëpisë në fshatin ***, duke shkaktuar kështu një konflikt interesi të paktën në dukje, të nxitur edhe më shumë nga shpejtësia me të cilën u vendos ky rast dhe u vendos në favor të babait të subjektit.

- 3. Shtëpi banimi në ish-objektin “***” Sarandë, ndërtuar para viteve 1990, lagjja nr. ***, godina nr. ***, me sipërfaqe objekti **48.9 m²**, kati parë i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, faqe ***, nr. *** indeksi, datë 21.4.1996. Përshtatur për banim në vitin 1994-1995. Shpenzimet për përshtatje për banim, nga të ardhura e kursime, gjatë këtyre viteve.**

Burimi i krijimit: Kontratë shitblerje me nr. ***, datë 14.2.1995, çmimi i blerjes **1.107.000 lekë**, në bashkëpronësi në 1/10 pjesë, ish-objekti “***” Sarandë, me sipërfaqe në

⁵ Faqja 3 e shpjegimeve të subjektit pas kalimit të barrës së provës.

bashkëpronësi 903 m², tek noteri A. L, Sarandë. Kontratë pjesëtimi nr. ***, datë 29.12.1995, noteri A. A, Sarandë. Vlera e pasurisë **110.700 lekë**. Zotërimi 100%.

3/1. Shtesë e katit, e ndërtuar mbi banesën ekzistuese, e përshkruar në pikën 3, me sipërfaqe **110 m²**, godina nr. *** Sarandë.

Burimi i krijimit: Leje ndërtimi “Rikonstruksion banese”, të dhënë me vendimin e KRRT-së, Bashkia Sarandë, nr. ***, datë 18.4.2002, për 8 bashkëpronarët e objektit.

Shpenzimet e kryera në vitin 2002 sipas preventivit dhe lejes së ndërtimit për 8 bashkëpronarët ka qenë 6.764.083 lekë = **845.510 lekë** për secilin.

Shpenzime të kryera brenda shtesës së katit, në vitin 2004 kanë qenë në shumën **595.400 lekë**, sipas preventivit.

Shpenzimet për ndërtimin e shtesës së katit në vitin 2002 dhe ato të kryera në vitin 2004, janë kryer nga lekët e dhëna me prokurën e posaçme nr. *** rep, datë 18.8.2000, tek noteri A. A Sarandë, nga prindërit K. e F. Ç, si dhe kursime të këtyre viteve.

Me vendimin gjyqësor me nr. ***, datë 25.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është njohur shtesa e katit të ndërtuar mbi banesën ekzistuese pas rikonstruksionit për efekt regjistrimi, (shkresa me nr. *** prot., datë 11.10.2016 të ZVRPP-së Sarandë) në proces regjistrimi pranë ZVRPP-së. Vlera e pasurisë **1.440.910 lekë**. Zotërimi 100%.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Shkresë nr. ***, datë 11.10.2016, nga ZVRPP-ja Sarandë. (cituar më sipër);
- Kontratë shitblerje nr. ***, datë 14.2.1995, vlera 1.107.000 lekë;
- Kontratë pjesëtimi nr. *** rep, nr. 1393 kol, datë 29.12.1995;
- Kërkesë për leje ndërtimi + vërtetim datë 30.9.1999 + seksion urbanistik + mandat banke + leje ndërtimi nr. 1 v. 2002 + aktmarrëveshje datë 01.12.2001 + kontratë ndërtimi datë 10.4.2002 + planimetri;
- Situacion punimesh, vlera 6.764.083 lekë, 845.510 lekë; 1/8 pjesë;
- Situacion punimesh, Alltun Çela, 595.400 lekë;
- Projekt rikonstruksioni;
- Vendimin gjyqësor me nr. ***, datë 25.7.2013, me palë paditëse: M. dhe Alltun Çela dhe palë të paditur: Bashkia Sarandë, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur të njohë pronarë dhe të regjistrojë në regjistrin hipotekor pasurinë më sipër.” (pranuar kërkesa)

Arsyetimi ligjor:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni konstaton se subjekti ka blerë në bashkëpronësi me 1/10 pjesë, katin e parë (faktik i dyti) të ***Sarandë me kontratë shitblerje me nr. ***, datë 14.02.1995. Nga shqyrtimi i kësaj kontrate rezulton se dhjetë bashkëpronarët, përfshirë edhe subjektin, kanë përfituar të gjithë sipërfaqen e katit të dytë, si dhe sipërfaqen e truallit në këtë objekt dhe në funksion të tij, gjithsej 451.5 m². Në kontratë nuk pasqyrohet mënyra e fitimit të pronësisë nga pala shitëse. Me anë të kontratës së pjesëtimin nr. ***, datë 29.12.1995, subjekti është bërë pronar i vetëm për sipërfaqen prej **48.9 m²**.

Kjo kontratë pjesëtimi nuk shprehet për ndarjen e truallit funksional. Me anë të lejes së ndërtimit, të dhënë me vendim nr. ***, datë 18.4.2002 të KRRT-së, Bashkia Sarandë, subjekti dhe 8 bashkëpronarë të tjerë kanë shtuar edhe një kat mbi katin e dytë që kishin në pronësi.

Konstatohet se leja e ndërtimit është dhënë për rikonstruksion dhe jo për shtesë kati. Një nga dokumentet e depozituar për këtë leje ndërtimi është aktmarrëveshja e datës 10.12.2001 midis 7 bashkëpronarëve për të ndërtuar mbi truallin funksional të ndërtesës.

Mbetet i paqartë fakti se si është marrë në pronësi sipërfaqja e truallit funksional të ndërtesës, kur blerësit kanë blerë katin e dytë dhe kati i parë që lidhet drejtpërdrejt me truallin u përket pronarëve të tjerë.

Bazuar në këtë leje ndërtimi, që në fakt është dhënë për rikonstrukcion banese dhe jo për ndërtim shtesë kati, subjekti dhe bashkëpronarët e tjerë kanë ndërtuar shtesë sipër në apartamentin ekzistues nga 48.9 m² në 110 m², si dhe shtesë kati në të njëjtën sipërfaqe.

Referuar deklaratës “Vetting”, ndërtimi i katit shtesë dhe zgjerimi i katit ekzistues ka përfunduar në vitin 2004. Më datë 05.07.2013, me cilësinë e paditësit, bashkëshortja e subjektit M. Ç dhe vetë subjekti, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me padinë: “Detyrimin e palës së paditur Bashkia Sarandë të na njohë pronarë me parashkrim fitues mbi një objekt shtëpi banimi dykatëshe e rikonstruktuar në lagjen nr. ***, Sarandë, e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. *** faqe, numër *** indeksi, datë 21.04.1998”.

Supozohet se ky vendim gjykate e ka thjesht lapsus datën e regjistrimit të pronës, që sipas deklaramit të subjektit është 21.04.1996. Çështja është gjykuar nga gjyqtar P. A. Konstatohet nga ky vendim se pala e paditur, Bashkia Sarandë, si dhe personi i tretë ZVRPP-ja Sarandë, nuk kanë kërkuar rrëzimin e padisë në respekt të pozicionit të tyre ligjor, por e kanë lënë në vlerësim të gjykatës. Në përfundim gjykata e ka pranuar padinë e paditësve dhe në bazë të nenit 126 dhe 306 të Kodit të Procedurës Civile, ka detyruar palën e paditur Bashkinë Sarandë të njohë paditësit M. dhe Alltun Çela pronarë me parashkrim fitues për të dy katet. Gjykata është shprehur me vendimin nr. ***, datë 25.07.2013, pra, 20 ditë pas regjistrimit të padisë. Komisioni konstaton përsëri shpejtësi jo të zakonshme në procedurat gjyqësore të ndjekura në këtë rast. Subjekti pretendon se vetëm ai i është drejtuar Gjykatës, sepse bashkëpronarët e tjerë nuk kishin përfunduar ndërtimin.

Në dokumentacionin e dërguar nga ana e ZVRPP-së Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2018, gjendet urdhri nr. ***, datë 05.05.2017 i regjistruarit të ZVRPP-së Sarandë, në arsyetimin e të cilit konstatohet se “nga përshtatja e aktekspertimit dhe planit të rilevimit rezulton se kjo pasuri prek pasurinë ***, vol. ***, faqe ***, në pronësi të Alltun Çela dhe pasurinë ***, vol. ***, faqe ***, shesh me sipërfaqe 300 m² në pronësi shtetërore”.

Në përgjigje të pyetësorit, përkatësisht pyetjes 14, subjekti më datë 06.11.2018 deklaroi se nuk ka kryer ndonjëherë punime ndërtimi në tokën e dikujt tjetër.

Në përfundim të hetimit ka rezultuar se:

- i. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar për këtë pasuri: përshtatur për banim në vitin 1994 – 1995. Për këtë, subjekti ka deklaruar edhe shpenzimet në deklaratën “Vetting”, ndërkohë që kontrata e shitblerjes mban datën 04.02.1995, ndërsa kontrata e pjesëtimit është e datës 29.12.1995. Është i paqartë fakti se si, sipas deklaramit të tij, subjekti e ka përshtatur për banim që në vitin 1994, pa u bërë ende pronar;
- ii. Në deklaramin e bërë në vitin 2003, subjekti ka deklaruar 48,9 m² apartament. Në vitin 2004 për këtë apartament deklaroi sipërfaqen 65 m². Në përgjigje të pyetësorit datë 06.11.2018 deklaroi se në kohën që është blerë ky objekt, sipërfaqja që ka blerë ka qenë 27,50 m² ballkon + 48,9 m² ndërtim + 33,60 m² truall para banesës. Subjekti duket kontradiktor në deklaramet e tij, deklarime që bien ndesh me deklaramin e tij “Vetting”;
- iii. Duket sikur subjekti ka vepruar në kundërshtim me lejen e ndërtimit që e ka patur për rikonstrukcion banese dhe jo për ndërtim të katit shtesë. Edhe procesverbali i mbledhjes

së KRRT-së i datës 18.04.2002 vënë në dispozicion nga vetë subjekti më datë 06.11.2018, e konfirmon këtë.

- iv. Mbetet i paqartë fakti përse i gjithë dokumentacioni që llogarit shpenzimet e ndërtimit dhe i ndan ato ndërmjet bashkëpronarëve, u referohet 8 bashkëpronarëve, ndërkohë që nga aktmarrëveshja e datës 10.12.2001 rezultojnë vetëm shtatë bashkëpronarë që kanë shprehur vullnetin. I njëjti fakt vihet re edhe në deklarinimin “Vetting” të subjektit. Subjekti nuk ka vërtetuar me dokument faktin e të qenët 8 bashkëpronarë për të justifikuar shpenzimet e deklaruara;
- v. Fakti që subjekti i është drejtuar gjykatës për të fituar pronësinë me anë të parashkrimit fitues kur ishte i pajisur me leje ndërtimi, siç pretendon ai, ngre dyshime nëse subjekti ka vepruar përtej lejes nga organi kompetent;
- vi. Mbetet i paqartë fakti përse subjekti nuk i është drejtuar ALUIZNI-t për legalizimin e ndërtimit pa leje, siç do të mund të ishte praktika ligjore e duhur;
- vii. Subjekti, së bashku me bashkëshorten e tij, i janë drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me objekt fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, kur vetë subjekti/pala paditëse është kryetar i kësaj gjykate, duke vepruar në kushtet e konfliktit të interesit;
- viii. Nga dokumentacioni i administruar duket sikur subjekti ka ndërtuar në tokën me pronar shtet, ndryshe nga sa ai deklaroi përpara Komisionit;
- ix. Subjekti ka vënë në dispozicion edhe kontratë qiraje me z. A. B për sipërfaqen prej 48.9 m², marrëdhënie kjo që ka zgjatur deri në vitin 2015, bazuar në dokumentacion. Kjo pasuri duket sikur është e padeklaruar nga subjekti, për aq kohë sa me vendim gjykate dhe dokumente të tjerë mbështetës, ka provuar pronësinë mbi dy kate prej 110 m². ZVRPP-ja Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 07.02.2018 nuk e ka konfirmuar këtë pronësi të subjektit;
- x. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar shtesë kati të ndërtuar mbi banesën ekzistuese (që është deklaruar 48, 9 m²) me sipërfaqe 110 m². Nga dokumentacioni i administruar si dhe përgjigjet e vetë subjektit më datë 06.11.2018 rezulton se subjekti ka në total katin e parë dhe të dytë me nga 110 m² secili, pra gjithsej 220 m², duke fshehur kështu pjesën prej 61,1 m².

Për të gjitha këto rezultate të hetimit të kryer nga Komisioni, subjektit iu kalua barra e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016.

i. Në lidhje me paqartësinë e Komisionit, për përshtatjen për banim të kësaj pasurie, pa u bërë ende pronar i saj, subjekti ka sqaruar se: *“Është e vërtetë që kontrata e pjesëtimit është bërë në datën 29.12.1995, por në fakt ne e kemi ndarë me marrëveshje dhe e kemi marrë në pronësi dhe në posedim, që në datën 14.02.1995 kur e kemi blerë. Pjesët takuese të pronës janë formalizuar me kontratën e pjesëtimit.”* Komisioni konstaton se referuar kontratës së shitblerjes të datës 14.02.1995, në faqen e dytë të saj, përcaktohet se: *“Dorëzimi i objektit është bërë më parë se redaktimi i kësaj kontrate.”*

ii. Pasi Komisioni konstatoi mospërputhje të deklaramëve të subjektit për sipërfaqen e banimit në deklarinimin e bërë në vitet 2003 dhe 2004 me deklaratën “Vetting”, subjekti ka pretenduar se: *“Pronësia që unë kam pasur që prej datës 14.02.1995 është e pandryshuar deri më sot dhe është e njëjta sipërfaqeërfaqe. Konkretisht 27,50 m² ballkon, pjesë e objektit të blerë (e cila s’është përfshirë në kontratë, por në fakt ka ekzistuar), 48.9 m² ndërtim i pjesëtuar dhe 33,60 m² është pjesë trualli, nga trualli në bashkëpronësi, pjesa ime takuese, e cila është marrë që*

në vitin 1995 në posedim, por që ka ngelur pa pjesëtuar dhe figuron si truall në bashkëpronësi....[...] Ndjesë për këtë pasaktësi nga ana ime. Pasi kam plotësuar deklaratën “Vetting”, e kam konstatuar këtë gabim, lajthitje, duke e nënkuptuar me paraqitjen e dokumenteve përpara jush.”

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të sipërfaqes së banimit në deklaramin e viteve 2003 dhe 2004. Këtë konstatim të Komisionit e përforcon edhe deklarami në seancë i subjektit, sipas së cilit sipërfaqja prej 27, 50 m² ballkon nuk është deklaram, sepse: *“Unë e posedoja, por nuk ishte regjistruar, sepse në bazë të ligjit “Për urbanistikën” ballkoni nuk regjistrohej si pronësi.”*

Edhe në deklaramtën “Vetting”, subjekti e ka deklaram këtë pasuri me sipërfaqe 48,9 m² dhe jo me sipërfaqen reale prej 110 m², duke kryer kështu deklaram të rremë. Për herë të parë subjekti ka deklaram saktësisht sipërfaqen prej 110 m² vetëm në përgjigje të pyetësorit të drejtuar nga Komisioni më datë 06.11.2018.

iii. Dyshimin e Komisionit se subjekti ka kryer veprime përtej lejes së ndërtimit, subjekti e ka sqaruar kështu: *“Në kërkesën drejtuar Bashkisë Sarandë për leje ndërtimi, ne kemi kërkuar që leja e ndërtimit të jepet me dy kate, dhe ashtu është miratuar numri i kateve mbi tokë të jetë 2, dhe jo rikonstruksion të katit të parë pasi ka qenë i banueshëm.”* Komisioni riverifikoi kërkesën e nënshkruar nga subjekti drejtuar sekretarisë teknike të KRRT-së në Këshillin e Rrethit Sarandë, dokument i depozituar nga vetë subjekti dhe konstaton se kjo kërkesë ka për objekt “Rikonstruksion banese ekzistuese”, duke e vënë kështu subjektin në kushtet e deklaramit të rremë përpara Komisionit. Edhe leja e ndërtimit e datës 06.11.2001 (e korrigjuar me shkrim dore), e lëshuar sipas kësaj kërkesë, ka dhënë miratimin për rikonstruksion banese L.nr. ***, përf. Alltun Çela.

Më tej subjekti e mbështet qëndrimin e tij edhe në pagesën e taksës. Sipas tij: *“Në bazë të shkresës së Urbanistikës së Bashkisë Sarandë drejtuar zyrës së Financës së Bashkisë Sarandë ne kemi paguar taksë për ndërtime të reja dhe jo taksë rikostruksioni. Kjo provon se leja e ndërtimit ka qenë për shtesë kati sipas projektit të miratuar.”* Pasi shqyrtoi këtë fakt, Komisioni konstaton se leja e ndërtimit është e datës 06.11.2001, ndërsa pagesa e taksës pranë Bankës së Kursimeve, me përshkrimin “Leje ndërtimi nga Bashkia”, paguar nga vetë subjekti, është e datës 03.12.2002, pra një vit më vonë. Në këto kushte, Komisioni nuk e vlerëson këtë si provë për të provuar gabimin e institucioneve shtetërore, siç ka deklaram subjekti.⁶

Në vijim të kësaj pike të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se: *“Në këtë rast ndërtimi i katit të dytë është ndryshim që i është bërë organizimit të ndërtimit të shtesës, pasi kati parë ka qenë i banueshëm dhe nuk kishte nevojë për rikonstruksion. Është ai që ka qenë që nga viti 1995. Vetëm pjesa e truallit 33,60 m² ka krijim të sipërfaqes me ndërtim sipas projektit (ndërtim sipas lejes).”*

Edhe në këtë deklaram të tij, subjekti bie ndesh me deklaramin e bërë në deklaramtën “Vetting”, sipas së cilës, në faqen 6, pika 4, ka deklaram si burim krijimi “leje ndërtimi, rikonstruksion banese të dhënë me vendim të KRRT-së Bashkia Sarandë, nr. 1, datë 18.04.2002”. Gjithashtu, edhe në vendimin gjyqësor nr. ***, datë 25.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konstatohet se është arsyetuar: *“Në kushtet që rikonstruksioni i banesës ka përfunduar që prej vitit 2002.....”*

⁶ Në shpjegimet e tij, në faqen 10, subjekti deklaram “Ky është një gabim në pasqyrim në dokumente nga ana e administratës së Bashkisë.”

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka vepruar në kundërshtim me lejen e ndërtimit, me të cilën ishte pajisur nga organet shtetërore kompetente.

iv. Në lidhje me përlogaritjen e shpenzimeve për këtë ndërtim/rikonstrukcion të banesës, subjekti ka sqaruar se: *“Kur është lidhur kontrata e ndërtimit dhe preventivi unë kam dhënë pjesën time prej 845 510 lekë, sipas mandat arkëtimeve të kohës. Kam deklaruar në deklaratën “Vetting” pasi marrëdhënia me firmën e ndërtimit ishte individuale. Njëri prej bashkëpronarëve u tërhoq dhe nuk ka ndërtuar, pasi nuk e përballonte nga ana financiare.”* Komisioni konstaton se kontrata e ndërtimit e datës 10.04.2002 është lidhur ndërmjet Alltun Çela, me cilësinë e përfaqësuesit të bashkëpronarëve, dhe sipërmarrësit D.B., dhe nuk është kontratë individuale, siç pretendon subjekti. Nga ana tjetër, vetë subjekti ka depozituar një aktmarrëveshje të datës 10.12.2001 të lidhur ndërmjet 7 (shtatë) bashkëpronarëve për të kryer ndërtimin. Në këto kushte, Komisioni nuk gjen asnjë arsye për të llogaritur shpenzimet e ndërtimit për 8 (tetë) bashkëpronarë, kur ndërkohë, që në fillim, aktmarrëveshja është bërë ndërmjet 7 (shtatë) prej tyre.

v. Duke qenë se subjekti ka pretenduar se ndërtimi është bërë me leje ndërtimi nga organi kompetent, por ai ka vërtetuar pronësinë e tij me anë të një vendimi gjyqësor, Komisionit i lindën dyshime për ligjshmërinë e veprimeve për këtë ndërtim. Nga ana tjetër, Komisioni e konsideroi të paqartë faktin se përse subjekti nuk iu drejtua ALUIZNI-t, por gjykatës.

Në shpjegimet e tij, faqja 10, subjekti ka deklaruar: *“Ndërtimi është kryer nga të gjithë pronarët e këtij objekti. Në rast se do të kishte devijim të lejes së ndërtimit, do të kishte konflikt. Ndërtimi i objektit është kryer sipas lejes së ndërtimit, projektit të miratuar dhe nuk ka asnjë devijim.”* Ky deklaram i subjektit është i kundërt i asaj që vetë subjekti ka dhënë një paragraf më lart, në shpjegimet e tij, ku ka sqaruar se një nga bashkëpronarët u tërhoq. Në këto kushte, Komisioni e ka të vështirë se cilën nga deklaratat e subjektit të besojë, duke mbetur dyshimi për ligjshmërinë e veprimeve për ndërtimin.

vi. Subjekti është bërë pronar i shtëpisë së banimit në ish-objektin “****”, Sarandë, me vendimin nr. ***, datë 25.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Në këtë kohë subjekti ushtron funksionin e kryetarit të kësaj gjykate. Komisioni ngriti dyshime për konflikt interesi në paraqitjen e padisë. Këto dyshime bazohen në faktin që është kryetari i gjykatës ai që shorton çështjet e ardhura në gjykatë, si dhe në faktin që gjyqtari i çështjes është i njëjti që ka marrë pjesë si ndihmësgjyqtar në vendimin nr. ***, datë 12.10.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë, që ka njohur si pronar të shtëpisë në fshatin *** babain e subjektit. Subjekti, në shpjegimet e tij, ka pretenduar se: *“I bëj me dije Komisionit se në të gjitha rastet e tjera ku palë kanë qenë gjyqtarët e kësaj gjykate, proceset janë zhvilluar në këtë gjykatë. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KLD-ja ku me vendimin nr. *** datë 11.10.2018 për një çështje të një gjyqtari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është shprehur se kur palë është gjyqtari i Gjykatës ku ushtron funksionin e tij çështja do të gjykohet po nga ajo gjykatë.”* Subjekti ka depozituar përveç këtij vendimi edhe vendimin nr. ***, datë 03.11.2010, vendimin nr. ***, datë 14.03.2001, vendimin nr. ***, datë 06.06.2000.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të KLD-së, konstatohet se në faqen 10 të procesverbalit të mbledhjes, më datë 11.10.2018, shkruhet: *“KLD-ja deri më sot ka mbajtur qëndrimin që ka deleguar gjyqtarë nga gjykatat e tjera në situata të tilla të procedurës civile.⁷ Në qoftë se do të ndryshohet praktika e KLD-së, në situatën aktuale ku jemi, ne kemi rekomanduar që vendimi duhet të jetë shumë mirë i arsyetuar për ta lidhur me parimin e sigurisë juridike, për të treguar që cila është situata që po ndryshojmë standardin që po ndjek KLD-ja.”*

⁷ Situata të tilla ku palë ndërgjyqëse është vetë gjyqtari.

Kjo do të thotë se justifikimi i subjektit me qëndrimin e KLD-së në raste të ngjashme, nuk është i vërtetë, sepse praktika ka ndryshuar në vitin 2018, ndërsa vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është i vitit 2013, pas miratimit të vendimit nr. ***, datë 03.05.2013 të KLD-së, që është shoqëruar edhe me “Formulari për kërkesën për delegim gjyqtari”. Edhe vendimet që ka depozituar subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, janë të një periudhe përpara vendimit nr. ***, datë 03.05.2013 të KLD-së.

Për më tepër, në kushtet kur pala kërkuese/paditësi është kryetar i Gjykatës që shqyrton kërkesën/padinë e tij, si dhe epror i gjyqtarit të çështjes, për sytë e publikut, por dhe për të garantuar paanshmërinë në gjykim, duhej të ishte kërkuar delegimi i një gjyqtari nga një rreth tjetër gjyqësor. Paneli e percepton këtë veprim të subjektit si një konflikt interesi.

Në këto kushte, Komisioni çmon se subjekti ka cenuar figurën e gjyqtarit, duke ushtruar veprimtarinë e tij si kryetar i gjykatës në kushtet e konfliktit të interesit. Në të njëjtën kohë ai ka cenuar besimin e publikut te një drejtësi e pavarur dhe e paanshme.

vii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit që bazohej në urdhrin nr. *** datë 05.05.2017 të regjistruarit të ZVRPP-së Sarandë se, subjekti ka ndërtuar në tokën me pronar shtetin, subjekti e ka kundërshtuar duke vënë në dispozicion shkresën nr. ***prot., datë 14.12.2018 me lëndë “Kthim përgjigje” të ZVRPP-së Sarandë, sipas së cilës: *“Në rastin konkret pasuria shtëpi banimi dykatëshe me sipërfaqe trualli 110 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 110 m², përfituar me vendimin nr. ***, datë 25.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ndodhet totalisht mbi pasurinë *** me përmasa 50 m x 25 m, ***, pjesë e së cilës është edhe pasuria ***sipas kontratës dhe planvendosjes së administruar në referencën dokumentare nr. *** të cilën po ju vëmë në dispozicion”*. Komisioni konstaton se e njëjta shkresë është dërguar pranë Komisionit me nr. 13052 prot., datë 07.12.2018.

viii. Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja me z. A. B për sipërfaqen prej 48.9 m². Duke qenë se një sipërfaqe e tillë nuk është konfirmuar në pronësi të subjektit nga ZVRPP-ja Sarandë, Komisioni ngriti dyshime për pasuri të padeklaruar. Në shpjegimet e tij, subjekti ka pretenduar se: *“Shtetasi A. B, nipi im, ka jetuar në banesën time nga viti 2010-2015, në banesën time në një kat, pasi banesa ka qenë që prej vitit 2004 e banueshme, sikurse kam deklaruar dhe në deklaratën e vitit 2004, por që nuk ka qenë e regjistruar në regjistrat e pasurive. Kjo është formalizuar me vendim gjyqësor dhe e regjistruar në vitin 2017, pas plotësimit të deklaratës “Vetting” 2017. Pra, nuk ka pasuri të padeklaruar pasi është deklaruar që me deklaratën e vitit 2004 dhe në deklaratën “Vetting” 2017.”*

Pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, Komisioni konstaton se sipërfaqja prej 48, 9 m² është vërtet sipërfaqe e deklaruar që në deklarinimin fillestar, por, me deklarinimet e mëtejshme, si dhe me vendimin gjyqësor të vitit 2013 e më tej me regjistrimin në ZVRPP-në Sarandë, nuk konfirmohet më ekzistenca e kësaj sipërfaqeërfaqe si një pasuri më vete, e shfrytëzueshme për ta dhënë me qira. Ashtu siç ka shpjeguar edhe subjekti, kjo sipërfaqe është shtuar në 110 m², si dhe me një kat më sipër me të njëjtën sipërfaqe. Gjithashtu konstatohet se subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja që në vitin 2010.

Komisioni konstaton se subjekti ka kryer deklarinim të pamjaftueshëm në lidhje me këtë rezultat të hetimit, duke mos krijuar bindjen në vërtetësinë e tij.

ix. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe shqyrtimit të deklaratës “Vetting” e dokumenteve mbështetës të saj, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklaruar sipërfaqe banimi 48,9 m², si dhe shtesë mbi banesën ekzistuese prej 110 m². Në përfundim, rezultati i hetimit ka qenë fshehje e pasurisë për sipërfaqen 61,1 m². Subjekti ka shpjeguar se: *“Në*

deklaratën “Vetting” pika 3, 4, kam renditur mënyrën e krijimit të pasurisë dhe në fund jam mjaftuar me pasqyrimin e vendimit gjyqësor ku sipas planvendosjes qartësohet sipërfaqja e banesës, për të dy katet e pandryshuar si në vitin 1995. Qartësisht nuk ka fshehje dhe mosdeklarim të sipërfaqes 61.1 m². Kjo sipërfaqe që është brenda sipërfaqes së katit të parë prej 110 m².”

Duke iu rikthyer deklaramit “Vetting”, konstatohet se shprehimisht subjekti në pikën 3⁸ ka deklaruar: “**Shtëpi banimi në ish-objektin “****”, Sarandë, ndërtuar para viteve 1990, lagjja nr. ***, godina nr. ***, me sipërfaqe objekti 48.9 m², kati parë i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, faqe ***, nr. *** indeksi, datë 21.4.1996, përshtatur për banim në vitin 1994 - 1995. Shpenzimet për përshtatje për banim, nga të ardhura e kursime, gjatë këtyre viteve.”**

Ndërsa në pikën 4⁹ ka deklaruar: “**Shtesë e katit, e ndërtuar mbi banesën ekzistuese, e përshkruar në pikën 3, me sipërfaqe 110 m², godina nr. 20 Sarandë.”** Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar ndër të tjera “*Me vendimin gjyqësor me nr. ***, datë 25.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është njohur shtesa e katit të ndërtuar mbi banesën ekzistuese pas rikonstruksionit, për efekt regjistrimi, (shkresa me nr. *** prot., datë 11.10.2016 të ZVRPP-së Sarandë) në proces regjistrimi pranë ZVRPP-së Sarandë.”*

Komisioni shqyrtoi edhe vendimin gjyqësor nr. ***, datë 25.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Konstatohet se në objektin e padisë është kërkuar detyrimi i palës së paditur Bashkia Sarandë të njohë pronarë paditësit me parashkrim fitues mbi një objekt: shtëpi banimi dykatëshe e rikonstruktuar, e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, faqe ***, nr. *** indeksi, datë 21.04.1998. Gjithashtu është kërkuar detyrimi i personit të tretë, ZVRPP-së Sarandë, të kryejë regjistrimin e pasurisë objekt dykatësh, me dy dhoma, dy banja, sallon me aneks, korridor dhe ballkon në çdo kat.

Komisioni konstaton se, si përfaqësuesi i palës së paditur, ashtu edhe përfaqësuesi i personit të tretë, në përfundim të gjykimit, kanë vlerësuar ta lënë çështjen në vlerësim të gjykatës, pa mbrojtur pozicionin e tyre ligjor.

Në përfundim të arsyetimit, gjykata ka vendosur detyrimin e palës së paditur të njohë paditësit M. dhe Alltun Çela, pronarë me parashkrim fitues mbi një objekt shtëpi banimi dykatëshe të rikonstruktuar në lagjen nr. ***, Sarandë (***), si dhe detyrimin e ZVRPP-së Sarandë të regjistrojë në emër të paditësve këtë objekt, me sipërfaqe ndërtimi 110 m² dhe trualli 110 m², duke përmendur dhe kufizimet përkatës. Në asnjë moment, në këtë vendim gjykate, nuk përmendet sipërfaqja totale e banimit e përbërë nga dy kate prej 110 m² secili (pra, në total 220 m²).

Edhe me shkresën nr. *** prot., datë 07.02.2018, ZVRPP-ja Sarandë informon se subjekti ka të regjistruar pranë kësaj zyre pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, apartament me sipërfaqe 110 m², regjistruar me dok/nr. *** (reference), zona kadastrale ***, Sarandë.

Për herë të parë, subjekti ka deklaruar sipërfaqen e plotë prej 220 m² vetëm në përgjigje të pyetësorit të bërë nga ana e Komisionit, më datë 05.11.2018. Madje për herë të parë Komisionit i është vënë në dispozicion kartela e pasurisë për këtë pronë, ku tek kuadrati “përshkrim i veçantë” pasqyrohet në mënyrë të detajuar “sipërfaqe trualli 110 m² dhe banesë dykatëshe me sipërfaqe ndërtimi dhe trualli 110 m² për kat”. Kjo kartelë është depozituar nga vetë subjekti, pas kërkesës së Komisionit, ndërsa vetë ZVRPP-ja Sarandë nuk na ka vënë në dispozicion një dokument me një përshkrim të veçantë të tillë. Sipas certifikatës për vërtetim

⁸ Faqja 5 e deklaratës “Vetting”.

⁹ Po aty, faqja 6.

pronësie, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë në pronësi apartament me sipërfaqe totale 110 m².

Në këto kushte, edhe pas shpjegimeve të subjektit, Komisioni gjykon se deklarimi i tij në deklaratën “Vetting”, në lidhje me këtë pasuri, është i rremë. Subjekti ka fshehur sipërfaqen prej 61.1m², duke krijuar konfuzion dhe paqartësi në deklaratimet e tij.

Në përfundim, për këtë pasuri Komisioni konkludon se:

- Subjekti ka bërë deklaram të rremë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me sipërfaqen e apartamentit të tij në deklaratat periodike të pasurisë, si dhe atë “Vetting”;
- Subjekti ka cenuar figurën e gjyqtarit, duke zgjeruar sipërfaqen e banimit të tij përtej lejes së ndërtimit të dhënë nga organi kompetent;
- Subjekti ka ushtruar funksionin e tij si kryetar gjykate në kushtet e konfliktit të interesit;
- Subjekti ka kryer fshehje të pasurisë prej 61.1 m².

4. Ambient magazinë, e ndërtuar para viteve 1990, përshtatur për banim, kati përdhe, poshtë banesës ekzistuese e përkrahur në pikën 3, me sipërfaqe. **51 m²**, lagjja nr. *** Sarandë, regjistruar në zonën kadastrale ***, nr. pasurie ***, volum ***, faqe ***, rr. “***” Sarandë.

Burimi i krijimit: Kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 17.8.2002, tek noteri G. N, me shitës S. K dhe blerës Alltun Çela e M. N. Çmimi i blerjes **1.000.000 (një milion lekë)** në 1/2 pjesë secili. Me kontratën e pjesëtimit nr. ***, datë 21.10.2016 të mbajtur nga noteri E. M, është bërë pjesëtimi në 1/2 pjesë.

Shpenzimet brenda ambientit, sipas kontratës së pjesëtimit datë 01.09.2002, vërtetuar tek noteri Th. K, nr. ***, datë 6.1.2003, janë në 1/2 pjesë secili, në shumën **510.967 lekë**, sipas preventivit.

Shpenzimet për blerjen dhe rregullimet brenda ambientit, janë nga të ardhurat nga kursimet dhe qiratë.

Të pesta pasuritë e mësipërme janë pasqyruar në shkresën me nr. *** prot., datë 11.10.2016, të ZVRPP-së Sarandë. Vlera pasurisë **755.484 lekë**. Zotërimi 100%.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerje nr. ***, datë 17.8.2002, me blerës Alltun Çela dhe M. N, vlera 1.000.000 lekë;
- Kontratë pjesëtimi datë 01.09.2002, bashkëpronarët bien dakord që secili do të mbajë ambientin poshtë banesës së tij, gjithashtu dhe shpenzimet dhe detyrimet që do bëhen do jenë 50%;
- Preventiv punimesh të investuara, vlera 510.967 lekë;
- Kontratë pjesëtimi nr. ***, datë 21.10.2016;
- Certifikatë pronësie nr. ***, në emër të Alltun Çela, për njësi, me sipërfaqe. 51 m², certifikata mban datë lëshimi 28.10.2016.

Arsyetimi ligjor:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se me shkresën nr. ***, datë 11.10.2016 të ZVRPP-së Sarandë konfirmohet bashkëpronësia e subjektit me M. N mbi pasurinë pjesë e magazinës me përmasa 11 x 9.15 m², në total 100, 65 m², (kati i parë, ***). Sipas deklaratës “Vetting”, bazuar në dokumentacionin mbështetës, subjekti dhe bashkëpronari M. N kanë bërë pjesëtimin e kësaj pasurie më datë 21.10.2016, duke përfutur secili sipërfaqen prej 51 m².

Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit certifikatën e pronësisë për këtë pasuri. Subjekti deklaroi se sipërfaqen e ndërtimit prej 51 m² në katin përdhe e shfrytëzojnë me raste të veçanta kur i vijnë të afërmit.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se: Subjekti ka deklaruar të ardhurat nga qiraja e këtij ambienti në bashkëpronësi deri në vitin 2008 si objekt me destinacion për saldim.¹⁰

Pas këtij deklarimi nuk ka më të dhëna për shfrytëzimin e kësaj pasurie deri në momentin e pjesëtimit më datë 21.10.2016;

- ⊗ Subjekti deklaroi se e përdori këtë ambient për mikpritjen e të afërmeve, por nuk ka deklaruar asnjëherë shpenzime për përshtatjen nga mjedis saldimi në banesë.

Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këtë rezultat të hetimit. Ai ka sqaruar Komisionin se: *“Pjesa, që unë kam marrë ka qenë e rregulluar që në vitin 2002, në periudhën kur është kryer dhe ndërtimi i shtesës së katit të banesës. Ambienti ka qenë i dhënë me qira si një i tërë. Fizikisht, sipas kontratës së pjesëtimit paraprak, ambienti ka qenë i ndarë në dy pjesë: pjesa ime e përshtatur për banim dhe pjesa e z. M. N përdorej për ambient saldimi. Me qira për saldim jepej gjysma e ambientit (magazinë) të pjesës që sot i përket z. M. N, kurse pjesa ime përdorej nga i njëjti person deri në vitin 2008. Të gjithë ambientin e kishte i njëjti person me qira deri në vitin 2008. Pas vitit 2008 pjesa ime në këtë ambient nuk është dhënë më me qira dhe unë e përdor në raste të veçanta kur më vijnë të afërmit. Ndërsa pjesa e z. M. N vazhdon ende sot magazinë. Nuk kam kryer shpenzime më për këtë objekt veç mirëmbajtje për ta kthyer në normalitet për banim, pasi përdorej nga personat që kishin marrë pjesën tjetër për punime saldimi.”*

- Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti mund të jetë korrekt në shpjegimet e tij.

5. Truall 400 m², parcela nr. *, blloku ***Sarandë. Burimi i krijimit:** Përfituar me vendimin nr. ***, datë 28.8.1999 të Këshillit të Bashkisë Sarandë, i papaguar, pa kontratë shitblerje, pa regjistruar në ZVRPP. Vlera pasurisë **5000 lekë**. Zotërimi 100%.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vendim nr. ***, datë 28.8.1999 të Këshillit të Bashkisë Sarandë + praktika.

Arsyetimi ligjor:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni ka konstatuar paqartësi për lidhjen e subjektit me këtë pasuri, si dhe mënyrën e fitimit të pronësisë së kësaj pasurie. Në vetëdeklarimin “Vetting”, subjekti shprehet: i papaguar, i paregjistruar, por i përfituar me vendim të Këshillit të Bashkisë Sarandë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se dokumenti që është depozituar nga subjekti për vërtetimin e pronësisë mbi këtë truall është një vendim (dublikatë) i kryetarit të Bashkisë Sarandë, i datës 15.07.2005. Ky vendim referon tek vendim i Këshillit Bashkiak Sarandë nr. ***, datë 28.08.1999, i bazuar në studimin urbanistik të miratuar nga KRRT-ja me vendimin nr. ***, datë 25.08.1999, pra, tri ditë përpara vendimit të Këshillit Bashkiak. Sipas vërtetimit të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Sarandë rezulton se ky vendim i këshillit bashkiak është marrë në bazë të kërkesës së datës (s’ka) të Alltun Çela, si investitor i sheshit të ndërtimit, blloku nr. ***, parcela nr. ***, me sipërfaqe 400m². Pra, kërkesa e subjektit duhet të jetë bërë midis datave 25.08.1999 dhe 28.08.1999.

Subjekti ka shpjeguar në përgjigjen e tij të datës 06.11.2018 se ka bërë kërkesë si të gjithë qytetarët për dhënie shesh ndërtimi pranë Bashkisë Sarandë, meqënëse në vitin 1997 nuk

¹⁰ Kontratë qiraje e datës 25.01.2003 me shtetasin Q. Ç.

kishte ambient të bollshëm për banim. Nga dokumentacioni i depozituar nga vetë subjekti rezulton se është pajisur me këtë shesh ndërtimi me vendimin e kryetarit të Bashkisë të datës 15.07.2005.

Në dokumentacionin shtesë të depozituar nga subjekti më datë 08.11.2018 subjekti ka depozituar përveç dokumentave që Komisioni i dispononte edhe më parë, edhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr. ***, datë 28.08.1999.

Në bazë të nenit 52 të ligjit 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës:

- ⊗ Për të provuar arsyet ligjore, mbështetur në dokumentacion, të përfitimit të këtij trualli.
- ⊗ Për të vërtetuar arsyet e përfitimit të truallit si investitor, siç cilësohet në vendim (dublikatë) të datës 15.07.2005, të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Sarandë.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka pretenduar se: *“Ashtu si kam shpjeguar më parë kam bërë aplikim për t’u pajisur me shesh ndërtimi për shkak se në periudhën në të cilën kam aplikuar kisha vetëm pasurinë me nr. *** indeks fq. ***, libri nr. *** të vitit 1998 në të cilën jetoja me bashkëshorten dhe fëmijët e mi. Prindërit e mi në atë kohë jetonin në banesën e ndodhur në fshatin ***. Si çdo qytetar kam bërë kërkesë dhe më është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Sqaroj përsëri se ky shesh ndërtimi ndodhet në një zonë pa studim urbanistik, jashtë zonës së banuar, shumë larg vijës bregdetare në zonë malore, i pashfrytëzuar nga ana ime, por që unë figuroj si aplikues vetëm në dokumentacion. Unë nuk kam investuar në këtë sipërfaqe trualli, pasi nuk kam kontratë shitblerje, nuk e kam përfituar si pronësi dhe nuk është në pronësinë time. Pra, nuk kam kryer asnjë lloj veprimi tjetër juridik të mëtejshëm. [...] Të gjithë ata qytetarë, me qindra që kanë përfituar troje nga Këshilli Bashkiak kanë proceduar me ndërtime ndërsa unë nuk kam ndërmarrë asnjë veprim mbi të duke e lënë pronë shtetërore. Kjo për faktin se nuk se nuk u bëra kurrë pronar dhe nuk mund të investoja mbi këtë pronë, sa kohë juridikisht s’jam pronar i saj.”*

Në lidhje me këtë pasuri të deklaruar, subjekti u pyet edhe në seancën dëgjimore nga vëzhguesi ndërkombëtar. Pyetjes “A keni qenë ju pronari i kësaj toke në ndonjë moment kohor?”, subjekti i është përgjigjur: *“Jo, nuk jam bërë në asnjë moment, pronar të bën kontrata e shitblerjes. Unë nuk kam një kontratë shitblerje, unë kam vetëm një akt që ka miratuar Bashkia. Bile unë mund të jem i vetmi në qytetin e Sarandës, që nuk kam ndërtuar një shesh të tillë. Të gjithë e kanë ndërtuar, unë e kam lënë duke qenë se isha njohës i ligjit, nuk e mora, e lashë. Thjesht e deklarova, se mund të thoja që ligji ma ka hequr, por thjesht e deklarova, që të ishte e deklaruar. Nuk kam asnjë të drejtë pronësie.”*

Duke shqyrtuar shpjegimet e subjektit, të depozituara me shkrim, si dhe qëndrimin e tij në seancë, Komisioni konstaton se ai nuk ka qenë për asnjë moment kohor pronar i këtij trualli. Kjo vërtetohet edhe me të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, si dhe atë të vënë në dispozicion nga subjekti. Megjithëse me cilësinë e gjyqtarit, si njohës i mirë i ligjit, siç deklaroi subjekti, ai ka pasqyruar në deklaratën “Vetting”, një pasuri që nuk e ka as në pronësi dhe as në përdorim.

Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioni konkludon se:

- ➔ Subjekti ka kryer deklaram të rremë për këtë pasuri.

6. Ambient, me sipërfaqe 30 m², lagjja nr. *, Sarandë, kati dytë, e pamobiluar.**

Burimi i krijimit: Kontrata e sipërmarrjes me nr. ***, datë 31.2.2011, tek noterja L. T, Sarandë. Paguar me këste. Likuiduar në vitin 2013, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë

27.12.2016, tek noteri A. A, Sarandë. Pa kontratë shitblerje, e paregjistruar në ZVRPP. Blerë me kursimet, gjatë këtyre viteve. Vlera e pasurisë **1.200.000 lekë**. Zotërimi 100%.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 31.2.2011, vlera **1.200.000 lekë**;
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.12.2015, z. G. Z deklaroi se është likuiduar plotësisht nga porositësi z. Alltun Çela.

Arsyetim ligjor:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, duket se subjekti ka qenë i saktë në deklaram. Në përgjigje të pyetjes sonë nëse ky mjedis shfrytëzohet, subjekti përgjigjet se mjedisi është ende i papërfunduar dhe ka bashkëngjitur dy foto.

Nga hetimi i mëtejshëm ka rezultuar:

- ⊗ Nga fotot e depozituara nga subjekti duket sikur janë pamje të dy ambienteve të ndryshme, sepse tek njëra është tavani i përfunduar, madje edhe ndriçimi, ndërsa te tjetra duket që tavani është ende i pambyllur. Nëse pretendohet se bëhet fjalë për të njëjtin ambient, pamjet duket sikur tregojnë për një sipërfaqe më të madhe se ajo e deklaruar prej 30 m².
- ⊗ Nga verifikimi në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Sarandë, konstatohet se çështja nr. *** me palë: S.B. kundër: Ç. Z, me datë regjistrimi 29.06.2010, me objekt: “Pavërtetësi kontrate”, është gjykuar nga subjekti Alltun Çela.
- ⊗ Ndryshe nga vendimet e tjera të verifikuara në faqen zyrtare, për këtë çështje bëhet i pamundur printimi i vendimit. Madje emri i gjyqtarit, si në të gjitha çështjet e gjykuara prej tij, në sistem paraqitet “A. Ç”.
- ⊗ Nga krahasimi i dokumentave rezulton se subjekti ka shqyrtuar çështjen gjyqësore me palë të paditur sipërmarrësin Ç. Z në vitin 2010 dhe në vitin 2011 ka nënshkruar me këtë palë ndërgjyqëse kontratën e sipërmarrjes për blerjen e pasurisë.

Pasi iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, subjekti ka pretenduar: “Nga ana ime është dhënë vendimi gjyqësor nr. ***, me datë regjistrimi 29.06.2010, me palë paditëse: S.B, palë e paditur: Ç. Z, me objekt: “Pavlefshmëri kontrate shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 01.03.2006”. Ky vendim nuk ka lidhje me objektin ku unë kam lidhur kontratë sipërmarrje, por me një sipërfaqe trualli në një zonë tjetër.

Kjo çështje, me vendim nr. ***, datë 28.01.2009 është gjykuar nga Gjyqtari R.D. Mbi ankimin e shtetasit Ç. Z, çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër dhe me vendim nr. ***, datë 26.04.2010 ka vendosur “*Prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim me tjetër trup gjykues*”. Kur kjo çështje është kthyer për rigjykim më ka rënë mua si gjyqtar dhe me vendimin nr. ***, datë 26.07.2010 është vendosur: *pushimi i gjykimit për shkak të mosparaqitjes së palëve. Unë nuk e kam gjykuar në themel këtë çështje dhe unë nuk kam dhënë vendim përfundimtar, pra, qartësisht nuk ka asnjë konflikt interesi me këtë shtetas.*”

Në lidhje me pretendimin e parë, se vendimi gjyqësor nr. ***, i dhënë nga subjekti nuk ka lidhje me objektin ku ai vetë ka blerë ambientin prej 30 m², Komisioni e konsideron të papranueshëm. Konflikti i interesit, i rezultuar nga hetimi administrativ, nuk mund të lidhet me pasurinë, por me palën shitëse, që në këtë rast është edhe palë ndërgjyqëse në çështjen gjyqësore të shqyrtuar nga subjekti. Në cilësinë e gjyqtarit, subjekti ka shqyrtuar çështjen me palë ndërgjyqëse sipërmarrësin në vitin 2010 dhe ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale shitblerjeje, po me këtë sipërmarrës, një vit më vonë.

Në lidhje me pretendimin e dytë të subjektit, Komisioni çmon se pavarësisht përfundimit të gjykimit, subjekti duke hyrë në marrëdhënie tregtare me palën ndërgjyqëse, pas përfundimit

të gjykimit, ka cenuar etikën e magjistratit dhe figurën e gjyqtarit, si dhe ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

Për sa i përket dyshimeve të Komisionit për sipërfaqen reale të këtij ambienti bazuar në fotot e vëna në dispozicion nga subjekti, ai ka sqaruar se këto dyshime kanë lindur nga këndi i fotografisë.

Me cilësinë e kryetarit të gjykatës, subjektit iu kalua barra e provës edhe për konstatimin e Komisionit në lidhje me pasqyrimin e ekstrakteve të vendimeve gjyqësore në faqen zyrtare të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Sarandë, ku vendimet e çështjeve të shqyrtuara nga subjekti rezultojnë në emër të “A. Ç”. Ai ka pretenduar se: “*Shfaqja e të dhënave në portalin e gjykatës nuk është për fajin e gjykatës, por të problemeve që gjeneron sistemi.*” Komisioni çmon se pavarësisht problemeve të sistemit elektronik, subjekti, duke qenë edhe kryetar i gjykatës, ka patur detyrim të kujdesej për rregullimin e gjendjes dhe pasqyrimin e saktë të të dhënave në faqe. Subjekti nuk arriti të bindë Komisionin për arsyet që ky problem elektronik shfaqet vetëm për çështjet gjyqësore të shqyrtuara nga ai dhe jo në rastet e gjyqtarëve të tjerë.

Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioni konkludon se:

- Subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit, duke cenuar etikën dhe figurën e gjyqtarit.
- Subjekti, me cilësinë e kryetarit të gjykatës nuk ka marrë asnjë masë për pasqyrimin me vërtetësi dhe transparencë të të dhënave të çështjeve gjyqësore në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

7. Nga përgjigja e ZVRPP-së Sarandë drejtuar Komisionit me shkresën nr. *, datë 07.02.2018, ka rezultuar se subjekti ka të regjistruar pranë kësaj zyre pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, njësi me sipërfaqe 102 m², regjistruar me dok/nr. *** (referencë), z.k. ***, Sarandë. Kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti.**

Arsyetimi ligjor:

Referuar informacionit shkresor të ardhur nga ZVRPP-ja Sarandë, Komisionit i lindën dyshime për pasuri të deklaruar dhe ka pyetur për këtë subjektin përpara mbylljes së hetimit. Në përgjigje të pyetëorit datë 06.11.2018, ai ka deklaruar se bëhet fjalë për pasurinë prej 903 m² në bashkëpronësi të 10 shtetasve, ndër ta edhe vetë subjekti. Ai pretendon se kjo pasuri është ndarë me kontratën e pjesëtimit të vitit 1995 në 1/10 pjesë secilit. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Sarandë më 05.05.2017 dhe është deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2017.

Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për fshehje të kësaj pasurie, njësi me sipërfaqe 102 m².

Subjekti ka sqaruar Komisionin se nuk ka një pasuri të tillë në pronësi të tij. Këtë sqarim ai e ka mbështetur edhe në shkresën nr. *** prot., datë 07.12.2018 të ZVRPP-së Sarandë, e cila konfirmon gabimin e bërë prej tyre në dërgim të një informacioni jo të saktë Komisionit. Komisioni vlerëson se nuk mund të fajësohet subjekti për pasaktësinë e informacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Sarandë.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura me shkrim dhe dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, Komisioni konkludon se:

- Subjekti nuk ka arritur të japë asnjë sqarim bindës apo të paraqesë prova në lidhje me mospërputhjen e sipërfaqes prej 500 m² të shtëpi + truall të përfituar me AMTP-në dhe përfitimit prej tij të sipërfaqes prej 600 m², sipas vërtetimit të Njësisë Administrative *** të datës 13.10.2016;
- Megjithë shpjegimet e subjektit, mbetet e paqartë se si shtëpia + truall e pasqyruar në AMTP me sipërfaqe 500 m², u regjistrua me vendim gjykate me sipërfaqe 600 m²;
- Subjekti ka kryer deklaram të rremë përpara Komisionit, për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga babai i subjektit, duke e konsideruar këtë shtëpi si trashëgimi, gjë që bie ndesh me vendimin nr.407, datë 12.10.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë;
- Subjekti nuk arriti të bindë Komisionin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë, kryetar i së cilës ishte vetë subjekti në kohën e shqyrtimit të çështjes, ishte e vetmja gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës së babait të subjektit për njohjen pronar të shtëpisë në fshatin ***, dhe se nuk kishte asnjë mënyrë për të shmangur konfliktin e interesit midis gjyqtarëve të çështjes dhe atij vetë si kryetar i kësaj gjykate;
- Subjekti ka bërë deklaram të rremë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me sipërfaqen e apartamentit të tij, tek ***, në deklaratat periodike të pasurisë, si dhe atë “Vetting”;
- Subjekti ka cenuar figurën e gjyqtarit, duke zgjeruar sipërfaqen e banimit të tij përtej lejes së ndërtimit të dhënë nga organi kompetent;
- Subjekti ka ushtruar funksionin e tij si kryetar gjykate në kushtet e konfliktit të interesit në disa raste;
- Subjekti ka kryer fshehje të pasurisë prej 61.1 m²;
- Subjekti ka kryer deklaram të rremë për sipërfaqen e truallit prej 400 m², duke e deklaruar si pasuri të tijën, kur nuk ka asnjë dokument pronësie;
- Subjekti, me cilësinë e kryetarit të gjykatës nuk ka marrë asnjë masë për pasqyrimin me vërtetësi dhe transparencë të të dhënave të çështjeve gjyqësore në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

ii. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 20.02.2018.

Në përfundim të këtij raporti, konstatohet përshtatshmëria e subjektit, por theksohet fakti se ky raport është hartuar në mungesë të informacionit nga një prej organeve ligjzbatuese.

Pas ardhjes së informacionit të munguar, me kërkesë të Komisionit nr. *** prot., datë 18.07.2018, DSIK-ja ka rishikuar raportin për subjektin Alltun Çela.

Në përfundim, DSIK-ja ka dërguar raportin me shkresën nr. *** prot., datë 24.07.2018, e deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. *** prot., datë 21.09.2018.

Në përfundim të të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Alltun K. Çela, me detyrë gjyqtar (kryetar) në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Sarandë, DSIK-ja konkludon në papërshtatmërinë e subjektit për vijimin e ushtrimit të detyrës.

Raporti i grupit të punës së DSIK-së (informacioni që përmbante) iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar për të krijuar bindjen në vërtetësinë e informacionit të ardhur nga agjensitë ligjzbatuese. Ky hetim konsistoi në verifikimin e rrethanave, përfshirë edhe atyre lehtësuese, që kishin çuar grupin e punës në konstatimin e papërshtatshmërisë së subjektit për vazhdimin e detyrës, si dhe vërtetësisë së ngjarjeve konkrete, me qëllim gjetjen e provave për realizimin e një procesi të rregullt ligjor.

Pasi iu vu në dispozicion raporti i deklasifikuar pjesërisht, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të sqaruar pozicionin e tij.

1. Alltun Çela ka dorëzuar pranë DSIK-së dy deklarata për kontrollin e figurës, nënshkruar prej tij më datë 25.10.2016 dhe më datë 26.01.2017, të cilat janë depozituar brenda afateve ligjore lidhur me plotësimin e dokumentacionit nga subjektet e rivlerësimit.

Në deklaratën e parë (25.10.2016) Alltun Çela ka deklaruar ndryshimin e mbiemrit (nga Celu në Çela) në Zyrën e Gjendjes Civile Sarandë me urdhrin nr. ***, datë 24.03.2006, ndërsa në deklaratën e dytë (26.01.2017) ky subjekt ka deklaruar ndryshimin e mbiemrit (nga Celu në Çela) në Zyrën e Gjendjes Civile Sarandë me vendim nr. ***, datë 24.03.2004.

Nga hetimi administrativ, rezultoi se subjekti e ka ndërruar mbiemrin me procesverbal nr. ***, datë 24.03.2004 të Zyrës së Gjendjes Civile të Bashkisë Sarandë.¹¹

Në lidhje me këtë, subjekti ka sqaruar se: “Në lidhje me pikën 1, ku në deklaratën e parë datë 25.10.2016, unë Alltun Çela kam deklaruar ndryshimin e mbiemrit nga Celu në Çela në Zyrën e Gjendjes Civile Sarandë sipas urdhrin nr. ***, datë 24.03.2004, vitin e deklarimit e kam pasqyruar gabim në shkrim, lapsus, në një kohë që viti i urdhrin të Zyrës së Gjendjes Civile Sarandë, ka qënë 2004. Qartësisht në deklaratën e datës 25.10.2016 urdhri i saktë që duhet shënuar është “**nr. ***, datë 24.03.2004.**” Qartësisht nuk ka fshehje, sa kohë që vërtetimi që unë kam ndryshuar mbiemrin ka qënë i dorëzuar.”

2. Sipas raportit të DSIK-së, deklarata e dytë për kontrollin e figurës, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit më datë 26.01.2017, përmban të dhëna më të detajuara në pjesën nr. 4 (të dhëna për punësimin) për vitet 1981 – 2008.

Nga shqyrtimi i këtij formulari të vetëdeklarimit, konstatohet se subjekti ka deklaruar:

- 01.06.1988-30.05.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, gjyqtar/kryetar gjykate;
- 28.05.2014 – aktualisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në detyrë.

Rezulton se ky deklarim i subjektit për punësimin e tij nuk përputhet me të dhënat e administruara nga KLD-ja.

Për këtë subjekti ka paraqitur sqarimin e tij duke qartësuar se është përsëri një lapsus nga ana e tij: “Kjo pasaktësi duhet saktësuar: **-Periudha 01.06.1998-28.05.2008, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.**” Për të vërtetuar këtë subjekti ka vënë dispozicion të Komisionit edhe kopje të faqes së regjistrin themeltar të punonjësve nr. 5

¹¹ Shkresa nr. *** prot., datë 19.10.2018 e Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Sarandë.

3. Bazuar në raportin e DSIK-së, rezulton se disponohen të dhëna në kohështrirje _____, ku për subjektin e rivlerësimit Alltun K. Çela (Çelo), ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive dhe ushtrim ndikimi të paligjshëm në disa procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, rastet si më poshtë vijon, për të cilat Komisioni ka hetuar:

- a. Në një të dhënë _____ dyshohet se gjyqtari i çështjes, A. Çela, ka ushtruar presion ndaj një ish – funksionari të urbanistikës Sarandë për të dhënë rryshfet, pasi ky i fundit në vitin 2006 është akuzuar nga prokuroria për shpërdorim detyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se nuk mund të provohet ky fakt. Nga hetimi i Komisionit është konstatuar një rast, kur subjekti, megjithëse është shprehur me vendim për dënimin e një shtetasi për shpërdorim detyre, më pas, e ka thirrur këtë shtetas me cilësinë e ekspertit për vlerësimin e pasurive të paluajtshme të paktën në dy raste, përkatësisht në vitin 2013 dhe 2014. Në lidhje me këtë, subjekti në seancë ka deklaruar se: *“Dy ekspertë janë në Sarandë të vlerësimit të pasurive, domethënë është ky dhe një tjetër. Nga lista zgjedha këtë, erdhi si ekspert dhe nuk kundërshtoi. Kjo është arsyeja që e kam marrë dhe nuk e kam marrë gjatë kohës që ka qenë i pandehur.”*

- b. _____, Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, A. Çela mund të ketë marrë një sasi të caktuar parash për favorizimin e dy shtetasve, të ndaluar për transport të klandestinëve me origjinë nga vendet arabe.

Komisioni, në kuadër të procesit hetimor administrativ, ka kërkuar dosjet gjyqësore përkatëse, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Nga kjo gjykatë u vunë në dispozicion të Komisionit vetëm vendimet për vleftësim të masës së arrestit në flagrancë, duke mos lejuar Komisionin të krijojë bindjen e brendshme në lidhje me informacionin. Subjekti ka pretenduar se: *“Unë jo vetëm në këtë rast, por gjatë gjithë karrierës sime si gjyqtar nuk mund ta shkëmbej drejtësinë me çfarëdo lloj favorit.”* Gjithashtu ai vuri në dispozicion të Komisionit një informacion nga Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, sipas së cilës nuk ka një çështje të tillë pranë kësaj gjykate.

- c. Dyshohet se gjyqtari A. Çela ka marrë një shumë të caktuar parash për ndryshimin e masës së sigurisë së një shtetasi të akuzuar për ndërtim pa leje, shkatërrim prone, mospagim taksash dhe fshehje të ardhurash.

Në përfundim të hetimit administrativ konstatohet se subjekti, pas dhënies së vendimit për caktimin e masës së sigurimit arrest me burg dhe vendimit për zbatimin e kësaj mase arresti, 5 ditë më vonë është shprehur me vendim për ndryshimin e kësaj mase nga arrest me burg në detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore. Shkak për këtë ndryshim ka qenë akti i ekspertimit i përgatitur nga ana e shtetasit të përmendur në pikën a), më sipër, me cilësinë e ekspertit.

Komisioni konstaton se subjekti, megjithëse është ndodhur përpara një informacioni të klasifikuar, arrin të diferencojë nga moria e çështjeve që ka shqyrtuar, vetëm një prej tyre, me këtë objekt. Pasi ka sqaruar në shpjegimet e tij procedurat që ka ndjekur, subjekti e ka vlerësuar këtë informacion të klasifikuar si shpifje dhe ofendim për të. Por ai nuk arrin të sqarojë përse ka përzgjedhur këtë rast për të sqaruar.

- d. Dyshohet se gjyqtari A. Çela ka ndikuar për favorizimin e çështjes së një shtetasi, lidhje e tij familjare.

Rasti nuk është gjykuar nga subjekti, prandaj ky informacion nuk mbështetet nga ndonjë dokument në dosje.

- e. Në lidhje me çështjen e pronave të shtetasve _____, ndodhur në Parkun Kombëtar të Butrintit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ku pjesë e trupit gjykues ka qenë gjyqtari A. Çela, pa praninë e përfaqësuesve të AKKP-së dhe Avokatit të Popullit, në muajin shtator 2013, ka nxjerrë urdhër ekzekutimi për ZVRPP-në Sarandë, për regjistrimin e pronës në emër të personave të sipërcituar.

Komisioni hetoi gjerësisht mbi këtë informacion të ardhur nga organet ligjzbatuese. Nga verifikimi në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë rezulton se subjekti Alltun Çela ka dhënë disa vendime në lidhje me vërtetimin e faktit për njohjen pronar me parashkrim fitues. Në pjesën më të madhe të këtyre vendimeve, gjykimi është kryer në mungesë të palës së paditur, AKKP-së dhe ZVRPP-së Sarandë. Midis këtyre vendimeve, janë edhe vendimet për pronat, që ndodhen në Parkun Kombëtar të Butrintit.

Subjekti ka pretenduar në shpjegimet e tij se: “... për çështjen e pronave të shtetasve të ndodhur në Parkun Kombëtar të Butrintit, mesa jam në dijeni, nuk është dhënë vendim për kthim të pronave në këtë zonë. Pronat që ka disponuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë nga unë si gjyqtar, ndodhen brenda zonës së Ksamilit, ku është e ndërtuar dhe qyteza e Ksamilit. Në këtë zonë përveç ndërtimeve me leje, janë legalizuar dhe ndërtimet pa leje nga shteti shqiptar.”

Përveç kësaj, subjekti ka pretenduar edhe se në çështjet gjyqësore, në të cilat ai ka qenë pjesë e gjykimit, “... në rast se toka do të ishte brenda zonës së mbrojtur, institucionet shtetërore duhet të njoftonin gjykatën në rast se kishin prova për këtë pretendim. Nga institucionet shtetërore nuk është paraqitur asnjë provë dhe nuk është kryer asnjë ekspertim, për të vërtetuar se këto prona ndodhen brenda Parkut Kombëtar të Butrintit”.

Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit si provë disa vendime gjyqësore, të cilat u shqyrtuan në raport me provat e administruara gjatë hetimit administrativ.

Pasi dëgjoi subjektin në seancë, shqyrtoi edhe shpjegimet e tij me shkrim, si dhe provat e paraqitura, në raport me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioni vlerëson se raporti i DSIK-së përmban elementët e parashikuara në nenin 38 të ligjit 84/2016 dhe ai konsiderohet i plotë dhe se subjekti nuk arriti të bindë për të kundërtën e rezultatit të këtij raporti.

- ➔ Në përfundim, Komisioni konkludon për subjektin e rivlerësimit Alltun Çela se është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.

iii. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 19.04.2018.

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është bazuar te:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 dokumente ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

I. GJETJET E KLD NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Gjatë viteve 2014, 2015, 2016, subjekti i rivlerësimit Alltun Çela ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 3 dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor. 2 prej këtyre vendimeve i përkasin vitit 2014 dhe 1 vendim i përket vitit 2016. Këto 3 vendime përshkruhen si më poshtë:

1. **Dokumenti 1.** Vendimi nr. ***, datë 16.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që i përket paditësit: M.B kundër të paditurit: CEZ Shpërndarje sh.a. Tiranë, me objekt: “Rikthim në punë dhe shpërblimin e dëmit”;
2. **Dokumenti 2.** Vendimi nr. ***, datë 31.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që i përket paditësit: A. Dh kundër të paditurit: AKKP Tiranë, me objekt: “Detyrim për nxjerrjen e aktit administrativ për njohjen dhe kthimin e pronës”;
3. **Dokumenti 3.** Vendimi nr. ***, datë 19.12.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që i përket pandehurit: O.M. i akuzuar për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

Nga analiza e këtyre tre vendimeve rezulton se:

- Vendimet janë të strukturuar, sipas elementëve të parashikuar nga ligji;
- Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit në ndërtimin e fjalive, duke përdoren në tërësi karakteret e gjuhës shqipe, me përjashtime të pakta në germa e fjalë të caktuara;
- Në analizë të përbashkët të tre dokumenteve konstatohet se subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve;
- Organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel mesatar.

II. GJETJET E KLD-së NGA VËZHGIMI I 5 DOSJEVE TË PËRZGJEDHURA SIPAS NJË SISTEMI RASTËSOR DHE OBJEKTIV

Gjetjet nga vëzhgimi i këtyre 5 dosjeve përshkruhen më poshtë.

1. **Dosja 1.** Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 08.04.2013 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë kundër të pandehurit R.M, i akuzuar për veprën penale të “Vrasjes me dashje në tentative”, të parashikuar nga nenet 76 e 22 të K.Penal, e **përfunduar me vendimin nr. *** , datë 25.11.2013;**

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 08.04.2013 dhe me shortin e datës 08.04.2013, i është caktuar gjyqtarit relator Alltun Çela, me anëtarë P. A dhe N. D.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur **7 muaj e 17 ditë**, në intervalin kohor 08.04.2013 – 25.11.2013 brenda afatit 12 mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “a” të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë caktuar 17 seancë gjyqësore, nga të cilat 9 seanca kanë qenë joproductive. Pengesë në 8 seanca joproductive janë bërë mungesa e mbrojtësit (4 seanca), kërkesa e mbrojtësit për t’u njohur me aktet (1 seancë), kërkesa e të pandehurit për të shtyrë seancën (2 seanca), kërkesa e mbrojtësit për të shtyrë seancën (1 seancë). Ndër 16 seanca gjyqësore, 8 prej tyre i janë dedikuar diskutimit përfundimtar të palëve dhe **gjykata ka dështuar të disiplinojë sjelljen e të pandehurit dhe të mbrojtësit për të shmangur zvarritjen.**

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosje është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk

ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka të dhëna apo kërkesa në dosje nëse ka patur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Vendimi gjyqësor është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 283 të K.Pr.Penale: pjesa hyrëse, përshkuese- arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës.

Në vendim janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe janë përdorur në tërësi karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi është i strukturuar dhe standardizuar. Teksti është i qartë, pa gabime dhe i argumentuar.

2. **Dosja 2.** Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 04.04.2014 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë kundër të pandehurve M. C dhe P.N, të akuzuar për veprat penale të vjedhjes me dhunë në bashkëpunim dhe të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, të parashikuara nga nenet 139 e 25 dhe 279 të K.Penal, **e përfunduar me vendimin nr. *** datë 22.05.2014.**

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 04.04.2014 dhe me shortin e datës 04.04.2014, i është caktuar gjyqtarit relator Alltun Çela, me anëtarë E. D dhe K. B.

Janë caktuar 3 seanca gjyqësore, të cilat kanë qenë produktive. Janë marrë masat për administrimin e procesit gjyqësor gjer në shpalljen e vendimit përfundimtar. **Ka pasur vonesë 18 minuta – 1 orë e 28 minuta në çeljen e 2 seancave gjyqësore**, që është justifikuar me mungesën e energjisë elektrike. Vonesat nuk kanë shkaktuar dështimin e seancave gjyqësore. Distancat kohore midis seancave gjyqësore kanë respektuar afatin 15-ditor të parashikuar nga neni 342/2 të K.Pr.Penale. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar, nuk konstatohen të meta.

Vendimi gjyqësor është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 283 të K.Pr.Penale. Gjyqtari nuk ka përdorur shprehimisht ndonjë parim të përgjithshëm dhe as ndonjë referencë në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore.

Pjesa e tretë - *dispozitivi i gjykatës* është rrjedhojë e analizës së kryer nga gjykata në pjesën përshkuese - arsyetuese. Disponohet për fajësinë e të pandehurve, caktohet masa e dënimit me burgim, **por është zbatuar keq neni 406 i K.Pr.Penale, për të pandehurin e deklaruar fajtor për dy akuza.**

Në vendim janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe janë përdorur rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi është i strukturuar dhe i standardizuar. Teksti është i qartë, pa gabime dhe i argumentuar.

3. **Dosja 3.** Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 01.09.2014 regjistrimi, që i përket paditësit: F.M kundër të paditurës: A.M, me objekt: “Zgjidhje martese dhe të pasojave që rrjedhin prej saj”, **e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.10.2014.**

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 01.09.2014 dhe me shortin e datës 05.09.2014, i është caktuar gjyqtarit Alltun Çela. Me vendimin e datës 03.09.2014 (**2 ditë para shortit**), gjyqtari ka caktuar seancën përgatitore të pajtimit në datën 16.09.2014 ora 09.00

Në seancën përgatitore të pajtimit, konstatohet se mbrojtësi kërkon që e paditura të japë shpjegime personalisht dhe të shtyhet seanca përgatitore. **Për këtë kërkesë nuk është disponuar me vendim, në shkelje të nenit 135/2 të Kodit të Familjes**, që urdhëron shtyrjen e seancës së pajtimit për rithirrjen e të paditurit.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Alltun Çela ka zgatur gjithsej **1 muaj e 24 ditë**, në intervalin kohor 03.09.2014 – 27.10.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 4-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “d” e aneksit 1 të sistemit të vlerësimit.

Rrjedhimisht, është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor i përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Nga shqyrtimi i kësaj dosje gjyqësore konstatohet se:

- Çështja gjyqësore është marrë për gjykim nga gjyqtari në datën 03.09.2014, ndërsa shorti elektronik është zhvilluar dy ditë më vonë, më 05.09.2014;
- Veprimet përgatitore të pajtimit të bashkëshortëve nuk kanë respektuar rigorozisht kërkesat e neneve 134 dhe 135 të Kodit të Familjes, pasi janë marrë shpjegimet e paditësit pa përsëritur edhe njëherë njoftimin e të paditurës, shpjegimet e paditësit janë marrë në prani të përfaqësuesit të tij dhe në seancë përgatitore ka dhënë shpjegime edhe përfaqësuesi i paditësit;
- Njoftimi i të paditurës është bërë me shpallje publike, por afati i shpalljes është në shkelje të afatit minimal 20-ditor të përcaktuar nga neni 133 i K.Pr.Civile;
- Janë caktuar 4 seanca, nga të cilat 3 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në një seancë joproduktive ka qenë njoftimi i parregullt i të paditurës;
- Seancat nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi, me justifikimin e shënuar në procesverbal se sallat e gjykimit nuk kanë qenë të lira. Kjo arsye nuk mund të verifikohet me aktet e paraqitura në dosje;
- Në dosje janë përfshirë rregullisht vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit, provat e paraqitura nga palët, procesverbali gjyqësor dhe vendimi gjyqësor, **por nuk është përfshirë akti drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile për përcjelljen e një kopjeje të vendimit gjyqësor përfundimtar.**

Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit në ndërtimin e fjalive dhe përdoren në tërësi karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi paraqitet me një strukturë unike. **Arsyetimi është i shkurtër dhe pa forcë argumentuese.**

4. **Dosja 4.** Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 13.05.2014 regjistrimi, që i përket paditësit shoqëria “***” sh.p.k kundër të paditurve shoqëria “***” sh.p.k dhe L.Q, me objekt: “Përmbushje detyrimi monetar nga kontrata e furnizimit”, **e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 12.11.2014.**

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 13.05.2014 dhe me shortin e së njëjtës datë, i është caktuar gjyqtarit Alltun Çela.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit ka zgatur gjithsej **5 muaj e 29 ditë**, në intervalin kohor 13.05.2014 – 12.11.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor i përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë kryer dhe dokumentuar veprimet proceduriale për organizimin e procesit gjyqësor, por janë konstatuar edhe të meta.

- Janë caktuar 10 seanca (1 seancë përgatitore dhe 9 seanca gjyqësore), nga të cilat 7 kanë qenë produktive. Pengesë në këto 3 seanca joproduktive kanë qenë mungesa e të paditurve dhe e ekspertit (1 seancë), fillimi me shumë vonesë i seancës gjyqësore (1 seancë) dhe mungesa e gjyqtarit, që merrte pjesë në një aktivitet të Reformës në Drejtësi (1 seancë).
- Në çeljen e seancave ka patur vonesë nga 4 minuta (seanca 1) deri në 5 orë e 11 minuta (seanca 4). Vonesa prej më shumë se 5 orë ka shkaktuar dështimin e seancës gjyqësore.

- Në 1 rast tjetër, seanca ka filluar 20 minuta përpara orarit të caktuar (seanca 5).
- 7 seanca janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë dokumentuar me regjistrim audio, ndërsa 3 seanca të tjera nuk janë zhvilluar në sallë me justifikimin se sallat kanë qenë të zëna me gjykime të tjera. Ky fakt nuk mund të verifikohet me aktet në dosje.
- Nga ana tjetër, qëndrimi i gjyqtarit nuk ka qenë uniform, sepse teksa 3 seanca nuk i ka zhvilluar në sallë me justifikimin se sallat kanë qenë të zëna, një seancë tjetër e ka filluar me mbi 5 orë vonesë me justifikimin se po priste të lirohej salla.
- Në një seancë gjyqësore ka munguar paditësi dhe gjyqtari ka vazhduar gjykimin pa hetuar mbi mungesën e paditësit dhe pa disponuar me vendim (seanca 6).
- Nuk është ndjekur në mënyrë strikte procedura e ekspertit sipas neneve 224/a, 225, 226 dhe 227 të K.Pr.Civile, pasi pasi nuk është lexuar formula e betimit, nuk u është dhënë fjala palëve për detyrat që do të zgjidhë eksperti, si dhe nuk janë cituar nga gjykata detyrat për ekspertin.
- Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e nenit 118/1 të K.Pr.Civile, por nuk dokumenton në të gjitha rastet shkaqet e mosrespektimit të orarit të fillimit të seancave gjyqësore.

Vendimi gjyqësor është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile. **Gjyqtari nuk ka përdorur ndonjë parim të përgjithshëm të së drejtës apo referenca në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore.** Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit në ndërtimin e fjalive dhe përdoren në tërësi karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi paraqitet me një strukturë unike. Arsyetimi është i qartë i kuptueshëm dhe i argumentuar.

5. **Dosja 5.** Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 24.05.2016 regjistrimi, që i përket kërkuesit P.K dhe personit të tretë DRSSh Sarandë, me objekt “Vërtetimi i faktit juridik të marrëdhënies së punës”, **e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.06.2016.**

Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 24.05.2016 dhe me shortin e të njëjtës datë, i është caktuar gjyqtarit Alltun Çela.

Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore rezulton:

- Veprimet përgatitore nuk përmbajnë elementët e kërkuar nga neni 158/a i K.Pr.Civile, në drejtim të shpjegimit të fakteve dhe të tregimit të provave. Rrjedhimisht, veprimet përgatitore nuk kanë qenë efektive, pasi një seancë gjyqësore është shtyrë për marrjen e provave të reja nga kërkuesi, ndonëse gjykimi është zhvilluar vetëm me pjesëmarrjen e tij dhe nuk ka patur fakte apo rrethana të reja të paraqitura;
- Në çeljen e 2 seancave, nuk është respektuar orari i planifikuar. Seanca 1 ka filluar 7 minuta përpara planifikimit dhe është vlerësuar se personi i tretë nuk është paraqitur pa shkak, ndonëse kjo seancë ka përfunduar pikërisht në kohën kur duhet të fillonte. Në rastin tjetër, seanca ka filluar me vonesë prej 4 minutash (seanca 2).

Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit në ndërtimin e fjalive dhe përdoren në tërësi karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi paraqitet me një strukturë unike. Arsyetimi është i qartë i kuptueshëm dhe i argumentuar.

III. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale të gjyqtarit Alltun Çela rezulton se ai ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti Tiranës në datën 31.03.1994. Pas studimeve, në datën 30.03.1995 është emëruar gjyqtar dhe kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Delvinë deri më 01.06.1998, kur transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Nga data 28.05.2008 e në vijim, mban detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Nuk konstatohet mospërputhje me të dhënat e deklaruara në formularin e vetëvlerësimit.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Alltun Çela janë paraqitur 11 ankesa (6 në vitin 2014 dhe 5 në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së.

8 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, nga të cilat 3 ankesa (2 të vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) me arsyetimin se pretendimet zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor, ndërsa 5 ankesa të tjera (2 të vitit 2014 dhe 3 të vitit 2015) me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë.

3 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është arkivuar me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara;
- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Apelit Administrativ;
- 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për shkelje etike është arkivuar me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Alltun Çela përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

IV. ANALIZA E GJETJEVE E KRYER NGA KLD-ja

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLD. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 3 vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën I të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”. Ndërsa 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara të subjektit të rivlerësimit Alltun Çela është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe e zbaton atë për zgjidhjen e çështjes gjyqësore. Citon normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, por nuk ndalet gjerësisht në analizimin e saj.

Njohuritë e tij procedurale janë të thjeshta, por të gjera për shkak të larmishmërisë së çështjeve që ka shqyrtuar. Ai i kushton rëndësi ecurisë procedurale, duke ndjekur procedurën e parashikuar nga ligji, si dhe duke marrë në shqyrtim me vendime dhe urdhra kërkimet e palëve. Megjithatë në disa raste, janë konstatuar edhe mangësi në njohuritë procedurale, siç janë procedura e veprimeve përgatitore (*shih* dosjen 5), procedura e veprimeve të pajtimit midis bashkëshortëve (*shih* dosjen 3), procedura e caktimit të detyrave të ekspertit (*shih* dosjen 4) apo procedura e zbritjes së dënimit me 1/3 nga gjykimi i shkurtuar, në rastin kur ndaj të pandehurit caktohet një dënim i bashkuar për dy vepra penale (*shih* dosjen 2)

Në përgjithësi, në vendimet gjyqësore të tij, gjyqtari Alltun Çela nuk përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, me përjashtim të një rasti ku është analizuar parimi i një procesi të rregullt ligjor (*shih* dokumentin 2). Në ndonjë rast, në funksion të

zbatimit të ligjit ai ka përdorur referenca nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë (*shih dokumentet 2 dhe 3*) apo referencë nga rekomandimet e Komitetit Ministrave të Këshillit të Evropës “Për mbipopullimin e burgjeve” (*shih dokumentin 3*). Këto raste i përkasin dokumenteve të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, ndërsa nga dosjet e përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nuk janë konstatuar të dhëna të tilla.

Ndër 5 dosjet e vëzhguara dhe 3 dokumentet ligjore, është konstatuar se 3 vendime nuk janë ankimuar në gjykatat më të larta (*shih dokumentin 3*, si dhe dosjet 3 dhe 5), ndërsa 5 vendime të tjera janë ankimuar. 4 vendime të ankimuara janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta (*shih dokumentet 1 dhe 2*, si dhe dosjet 1 dhe 4). Në një prej këtyre 4 rasteve, vendimi i Gjykatës së Apelit është rekursuar në Gjykatën e Lartë, e cila nuk ka dhënë ende vendim (*shih dosjen 4*). **Në 1 rast, vendimi penal i dhënë nga gjyqtari Alltun Çela është ndryshuar nga Gjykata e Apelit lidhur me keqzbatimin e ligjit për uljen e 1/3 së dënimit nga gjykimi i shkurtuar**, si dhe lidhur me ometimin për të disponuar mbi provën materiale (*shih dosjen 2*).

Gjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtarin Alltun Çela janë paraqitur 11 ankesa, ndër të cilat 2 ankesa janë verifikuar për mosrespektim formal të ligjit. Në 1 rast, ankesa është arkivuar pas verifikimit, pasi pretendimet nuk janë vërtetuar, ndërsa rasti i dytë është ende në proces verifikimi (*shih të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së*).

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Alltun Çela ka aftësi mesatare në arsyetimin ligjor. Në tërësi respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e standardizuar në formë unike, duke i shërbyer funksionit të qartësisë. Nga pikëpamja formale, vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal (*shih dokumentin 3*, si dhe dosjet 1 dhe 2) apo kërkesat e legjislacionit procedural civil (*shih dokumentet 1 dhe 2*, si dhe dosjet 3, 4 dhe 5). Nga ana tjetër, standardizimi i vendimeve ka shkaktuar që ai bën pjesë të vendimit arsyetimin mbi juridiksionin, kompetencën lëndore dhe kompetencën tokësore, ndonëse ato janë çështje të qarta, të konsoliduara nga praktika gjyqësore dhe nuk janë kundërshtuar as nga palët në proces (*shih dokumentet nr 1, nr 2 dhe 3*). Në një rast, është konstatuar se nuk ka disponuar për provën materiale të sekuestruar në procesin penal, mangësi që është riparuar nga Gjykata e Apelit (*shih dosjen 4*). Ndërsa në një rast tjetër, arsyetimi i vendimit për zgjidhjen e martesës midis palëve ndërgjyqëse është konstatuar të jetë tepër sintetik dhe pa forcë argumentuese (*shih dosjen 3*).

Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai i arsyeton vendimeve e ndërmjetme duke referuar shkakun dhe bazën ligjore. Në raste sporadike ka mangësi në këtë drejtim (*shih dosjen 4 lidhur me verifikimin e prezencës së palëve dhe detyrat e ekspertit*).

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Alltun Çela në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit dhe të kryetarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Lidhur me ngarkesën sasiore, ai ka deklaruar se tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës 08.10.2013-08.10.2016, i janë caktuar për gjykim 1472 çështje, nga të cilat ka përfunduar 1442 çështje. Numri i çështjeve të mbartura vitin e fundit është 30. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 97.9 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtari Alltun Çela ka përfunduar gjithsej 1410 çështje gjyqësore, nga të cilat 420 çështje penale (190 çështje themeli, si dhe 229 çështje administrativo-penale dhe masa sigurimi), 819 çështje civile të përgjithshme (604 çështje themeli, si dhe 215 çështje administrativo-penale dhe urdhra ekzekutimi) dhe 171 çështje familjare (129 zgjidhje martesë dhe 42 urdhra mbrojtjeje). Këto të dhëna tregojnë se ai ka gjykuar gjithsej 923 çështje gjyqësore sipas standardit sasior.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Alltun Çela është efektiv në përfundimin në kohë të gjykimeve, që është tregues i lidhur me aftësitë për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim. Në 1 rast çështja është marrë nga gjyqtari i cili është njëkohësisht edhe kryetar gjykate 2 ditë përpara shortit **në kundërshtim** me vendim e KLD-së nr. 238/1/a datë 24.12.2008 “Për procedurat e marrjes me short të çështjeve gjyqësore” (*shih* dosjen 3). Në 3 çështje civile të vëzhguara, në 1 rast nuk ka kryer veprimet përgatitore me të gjitha elementët e përcaktuar nga neni 158/a të K. Pr. Civile. Në të njëjtën çështje civile, veprimet përgatitore nuk kanë qenë efektive, pasi një seancë gjyqësore është shtyrë për marrjen e provave të reja nga kërkuesi, ndonëse gjykimi është zhvilluar vetëm me pjesëmarrjen e tij dhe nuk ka patur fakte apo rrethana të reja të paraqitura. (*shih* dosjen 5).

Ndër 5 çështjet e vëzhguara, 2 prej tyre kanë përfunduar me 3 seanca (*shih* dosjet 2 dhe 5), 1 çështje me 4 seanca (*shih* dosjen 3), 1 çështje me 10 seanca (*shih* dosjen 4) dhe 1 çështje me 17 seanca (*shih* dosjen nr. 1). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 37 seanca të zhvilluara prej tij, 25 prej këtyre seancave kanë qenë produktive, ndërsa 12 seanca kanë qenë joproductive (*shih* dosjet 1, 3 dhe 4).

Gjyqtari Alltun Çela në tërësi respekton afatet ligjore në caktimin e seancave, duke mbajtur në konsideratë edhe shkakun që shtyn seancën gjyqësore. Nga verifikimi i 37 seancave gjyqësore janë konstatuar 5 seanca të caktuara në shkelje të afateve ligjore: 1 seancë civile është caktuar mbi afatin 5 ditor të përcaktuar nga neni 302 i K.Pr.Civile (*shih* dosjen 4), 2 seancë penale janë caktuar mbi afatin 15 ditor të përcaktuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale, ku vetëm 1 prej tyre justifikohet me lejen vjetore të gjyqtarëve (*shih* dosjen 1), ndërsa 2 seanca të tjera civile me shpallje publike janë caktuar nën afatit minimal 20-ditor të përcaktuar nga neni 133 i K. Pr. Civile.

Nga 5 çështjet e shqyrtuar, vetëm në 3 prej tyre seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi, duke u dokumentuar edhe me regjistrim audio (*shih* dosjet 1, 2 dhe 5). Ndërsa në 2 çështjet e tjera, seancat janë zhvilluar pjesërisht në sallë (*shih* dosjen 4) ose nuk janë zhvilluar fare në sallë (*shih* dosjen 3).

Seancat gjyqësore të vëzhguara janë çelur në 12 raste me vonesë nga 4 minuta (*shih* dosjen 1) deri në 5 orë e 11 minuta (*shih* dosjen 4). Në 2 raste, seanca është çelur para orarit të planifikuar 7 - 20 minuta (*shih* dosjet 4 dhe 5). Shkak për vonesën është relatuar mungesa e koordinimit me gjykimet e tjera që janë zhvilluar në sallë nga gjyqtarë të tjerë (*shih* dosjen 4) apo mungesa e energjisë elektrike (*shih* dosjen 2). Duhet theksuar se qëndrimi i gjyqtarit nuk ka qenë uniform, pasi në disa raste seancat nuk i ka zhvilluar në sallë, duke respektuar orarin e planifikuar me arsyetimin se sallat janë të zëna (*shih* dosjen 3), ndërsa në disa raste të tjera, i ka filluar seancat me vonesë nga planifikimi për të njëjtin shkak. Po ashtu, duhet theksuar se nga pikëpamja e dokumentimit, rastet e vëzhguara kanë qenë të përpikta, pasi janë evidentuar edhe vonesat prej 4 minutash në fillimin e seancës gjyqësore. Rrjedhimisht, konkludohet që

shkaku i vonesës nuk lidhet me ngarkesën sasiore të tij, por me identifikimin e sallave të lira të gjykimit dhe mungesën e energjisë elektrike.

Gjatë shqyrtimit të 5 dosjeve janë konstatuar edhe mangësi procedurale. Kështu, në një çështje civile nuk janë respektuar nenet 175 dhe 179 të K.Pr.Civile për shkaqet dhe mungesën e palës paditëse (*shih* dosjen 4); në të njëjtën çështje, ka vlerësuar se për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme dhe ka vendosur thirrjen e ekspertëve të fushës, por **procedura nuk është ndjekur rigorozisht dhe detyrat nuk kanë qenë të plota**, duke shkaktuar ekspertimin shtesë (*shih* dosjen 4). Në 1 rast nuk është shtyrë seanca e pajtimit të bashkëshortëve, por bashkëshorti paditës ka dhënë shpjegimet, madje në prani të mbrojtësit të tij, në shkelje të neneve 134/2 dhe 135/2 të K. Familjes (*shih* dosjen 3); në një çështje penale është konstatuar se ndër 16 seanca gjyqësore të planifikuara, 8 prej tyre i janë dedikuar diskutimit përfundimtar të palëve dhe gjykata ka dështuar të disiplinojë sjelljen e të pandehurit dhe të mbrojtësit për të shmangur zvarritjen (*shih* dosjen 1).

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në 1 rast çështja është marrë nga gjyqtari i cili është njëkohësisht edhe kryetar gjykate **2 ditë përpara shortit** në kundërshtim me vendim e KLD nr. *** datë 24.12.2008 “Për procedurat e marrjes me short të çështjeve gjyqësore” (*shih* dosjen 3).

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesional

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave ndaj gjyqtarit Alltun Çela janë paraqitur 11 ankesa përgjatë periudhës së rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016. Një prej këtyre ankesave është verifikuar për pretendime që lidhen me etikën e gjyqtarit, por në fund ajo është arkivuar pasi është konstatuar se pretendimet kanë qenë të pabazuara. Ndërsa sipas regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Alltun Çela përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Është e vërtetë që janë konstatuar 12 seanca gjyqësore të filluara me vonesë nga 4 minuta deri në 5 orë e 11 minuta, por kjo e dhënë është vlerësuar tek Aftësitë Organizative të Gjyqtarit, pasi nuk duket të jetë e lidhur me shkelje të disiplinës në punë.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Alltun Çela dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Alltun Çela. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Alltun Çela komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në

seancat gjyqësore. Në rastet kur iu drejtohet të tretëve me shkresa, konstatohet se gjuha është e sjellshme dhe brenda etikës gjyqësore. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Alltun Çela për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Në këtë aspekt duhet evidentuar se ka patur 12 seanca gjyqësore të dështuara nga planifikimi, që tregon mungesë të produktivitetit të punës së tij, pasi edhe si titullar gjykate nuk ka bashkëveprimin normal me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore lidhur me administrimin e sallave të gjykimit.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Alltun Çela pas përfundimit të Fakultetit të Drejtësisë (kurs i përshpejtuar) ka ushtruar funksionin si gjyqtar në fushën e të drejtës civile, familjare dhe penale, por nuk ka specializime në asnjë fushë të së drejtës.

iv. Pranë Komisionit janë paraqitur 7 denoncime për subjektin Alltun Çela

1. Denoncimi i shtetasit E. S.

Pas shqyrtimit të këtij denoncimi, konstatohet se nuk ka indicie për të provuar pretendimin e denoncuesit.

2. Denoncimi i shtetasit A. Z.

Nga shqyrtimi i denoncimit konstatohet se bëhet fjalë për një çështje penale që është ende në gjykim, në këto kushte Komisioni nuk mund të shprehet. Nga ana tjetër, denoncimi nuk ka paraqitur prova dhe fakte për akuzën e korrupsionit ndaj subjektit.

3. Denoncim i shtetasit V. Ç.

4. Denoncim i shtetasit V. Ç.

Të dy denoncimet janë në grup, për disa gjyqtarë e prokurorë. Nga shqyrtimi i tyre nuk rezultojnë të dhëna që të provojnë pretendimin e denoncuesit në lidhje me këtë subjekt.

5. Denoncim i shtetasit F.K.

Në këtë denoncim, shtetasi, ndër të tjera denoncon faktin se subjekti me vendim nr. ***, datë 29.03.2000 ka njohur pronësinë e Komunitetit Mysliman Gjyrokastër mbi prona për të cilat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ishte shprehur me vendim nr. ***, datë 17.10.1998, vendim ky që kishte marrë formë të prerë, sipas shënimit nga sekretaria. Në këtë mënyrë denoncuesi pretendon për konflikte pronësore të krijuara pikërisht për shkak të këtij vendimi të dhënë nga subjekti. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit, rezulton se ka një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me nr. ***, datë 17.10.1998, që ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar.

Për një pjesë të pronave për të cilat gjykata është shprehur me vendim që në vitin 1998, subjekti, me cilësinë e gjyqtarit kryesues, i asistuar nga dy ndihmësgjyqtarë, është shprehur me një vendim tjetër nr. 176, datë 29.03.2000.

Konstatohet se baza ligjore e të dy vendimeve është e njëjtë. Ky fakt nuk përputhet me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2012, që subjekti me cilësinë e kryetarit të gjykatës i ka kthyer palës së interesuar. Në këtë shkresë subjekti pretendon se vendimi i vitit 1998 është vërtetim fakti (deklarativ), që ka shërbyer për njohjen e pronësisë nga AKKP-ja.

Në lidhje me këtë subjektit iu kalua barra e provës, për të shpjeguar pozicionin e tij.

Ai e ka konsideruar ankesën e shtetasit F.K. si të pabazuar në prova e në ligj. Subjekti ka shpjeguar se ka qenë pjesë e trupit gjykues në vendimin nr. ***, datë 29.03.2000, por nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues në vendimin nr. ***, datë 17.10.1998. Më tej ai ka pretenduar se: *“Të dy këto vendime janë vendime deklarative ku subjektet kanë kërkuar në gjykatë njohjen e pronësisë për të saktësuar vendndodhjen dhe kufizimet e ish pronësisë së tyre, për t’i paraqitur në KKK Pronave për të konfirmuar pronësisë, sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për K.K.Pronave ish-pronarëve..... Në rast se do të provohet se ndërmjet këtyre pronave ka mbivendosje nuk është në fajin e gjykatës që institucionet shtetërore kanë krijuar planvendosjen e pretendimit të pronës pa e verifikuar. Në rast se mbivendosja e pronave do të provohet atëherë çdo palë ka të drejtën e kundërshtimit në gjykatë, që deri më sot nuk është ngritur një pretendim i tillë nga asnjë palë me sa jam në dijeni.”*

Pasi shqyrtoi shpjegimet e tij të paraqitura me shkrim, Komisioni vlerëson se subjekti ka reflektuar cilësi të dobëta në gjykim e arsyetim, ai nuk ka kryer një hetim të plotë mbi gjendjen, në mënyrë që të shmangë konfliktet e mëtejshme për mbivendosje pronash, përkundrazi, me cilësinë e kryetarit të gjykatës i ka nxitur palët t’i drejtohen gjykatës, duke nxitur kështu një konflikt gjyqësor.

6. Denoncimi i shtetasit H.M.

Denoncimi i këtij shtetasi ka të bëjë me dënimin penal të dhënë nga subjekti, përtej dënimit të kërkuar nga prokurori. Nga shqyrtimi i vendimeve penale për këtë shtetas të kërkuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, rezulton se ka një çështje penale nr. ***, datë 28.03.2006, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Subjekti është shprehur me vendim nr. 87, datë 18.10.2007 për dënim të këtij shtetasi, vendim ky i prishur nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim, nga një tjetër trupë gjykuese, duke çmuar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat procedurale penale për paraqitjen e akuzave të reja. Konstatohet se prokurori ka kërkuar dënimin me 2 (dy) vjet burgim, ndërsa gjykata, në përfundim është shprehur me vendim për dënimin me 3 (tre) vjet burgim.

Nga shqyrtimi i çështjeve gjyqësore me gjyqtar subjektin Alltun Çela, rezulton se pikërisht denoncuesi, i dënuar prej subjektit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, është thirrur nga gjykata me cilësinë e ekspertit, në çështjen nr. *** dhe çështjen nr. ***.

Në lidhje me këtë subjektit iu kalua barra e provës, për të shpjeguar pozicionin e tij.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar se: *“Në lidhje me ankesën e ankuesit H.M, se unë si gjyqtar kam dhënë dënim përtej dënimit të kërkuar nga prokurori është e vërtetë, por në bindjen time të brendshme si gjyqtar dhe bazuar në ligj unë kam çmuar atë vendimmarrje të cilën dhe sot e quaj të drejtë.”* Ndërsa në seancë, në lidhje me këtë çështje, ai ka mbajtur këtë qëndrim: *“Pretendimet e tij se më ka dënuar shumë ose më ka dënuar pak, për mua janë të pabazuara. Të vijë të përballet kushdo dhe të më thotë, më ke bërë presion. Unë kam bërë presion vetëm ligjit, jam bazuar vetëm në ligj dhe sikur sot të vijë ai i pandehur, unë prap atë vendimmarrje do të jap. Se Saranda është bërë një katrahurë e vërtetë, ju e keni vetë parasysh se si është bërë Saranda sot. Në rast se do të ishin frenuar gjykatat më të larta, atëherë nuk do të ishte kjo situatë që është sot në Sarandë.”*

Komisioni konstaton se subjekti nuk dha asnjë shpjegim ligjor në lidhje me shkeljen e dispozitave procedurale penale, që ishte dhe shkaku i kthimit për gjykim me një tjetër trup gjykues nga ana e Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, ku ndër të tjera theksohet se gjykata duhej t'i ishte përmbajtur akuzës së paraqitur nga prokurori, duke e konsideruar këtë gjykim si një proces jo të rregullt ligjor, si rezultat i shkeljes së dispozitave që lidhen me paraqiten e akuzave të reja.

Në lidhje me rezultatin e hetimit administrativ, se këtë shtetas, që ai vetë në cilësinë e gjyqtarit e ka dënuar për shpërdorim detyre, e ka thirrur si ekspert për vlerësimin e pasurive të paluajtshme në gjykime të mëvonshme, subjekti e ka justifikuar: *“Unë si gjyqtar e kam thirrur si ekspert, pasi çështja penale në ngarkim të këtij shtetasi kishte marrë formë të prerë me vendimin nr. *** datë 19.07.2012, të lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 19.04.2013 dhe akuza në ngarkim të tij ishte pushuar”*. Ndërsa në seancë u shpreh: *“Dy ekspertë janë në Sarandë të vlerësimit të pasurive, domethënë është ky dhe një tjetër. Nga lista zgjedha këtë, erdhi si ekspert dhe nuk kundërshtoi. Kjo është arsyeja që e kam marrë dhe nuk e kam marrë gjatë kohës që ka qenë i pandehur.”*

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk është bindës në argumentat e sjellë. Ky vlerësim përforcohet edhe më shumë nga deklarimi i subjektit në seancë se: *“Unë e kam gjykuar dhe po të më vijë i njëjti rast, kam po të njëjtin vendim për të dhënë.”* Por pavarësisht faktit që ky shtetas është dënuar nga subjekti në cilësinë e gjyqtarit për shpërdorim detyre, subjekti ka vazhduar ta caktojë atë si ekspert në disa çështje gjyqësore, pas dënimit të tij.

7. Denoncim anonim

Ky denoncim, megjithëse anonim, u vlerësua nga Komisioni. Denoncuesi pretendon se të gjitha pasuritë e F. L, babai i dhëndrit të subjektit, por që nga hetimi rezulton edhe person tjetër i lidhur për shkak të huas që i ka dhënë subjektit, janë pasuri të vetë subjektit.

Nga hetimi rezulton se bazuar në përgjigjen e ZVRPP-së Sarandë nr. *** prot., datë 26.10.2018, në emër të F. L figurojnë këto pasuri të paluajtshme:

- godinë banimi 2 kate me nr. pasurie ***, sipërfaqe trualli 158.5 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 108.5m²;
- njësi me sipërfaqe 296 m², me nr. pasurie ***, vol ***, faqe *** (në bashkëpronësi);
- apartament me sipërfaqe 150m², me nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***.

Ndërsa nga përgjigjet e bankave për F. L rezulton se:

- 15 banka kanë sjellë përgjigje “jo klient”;
- Raiffeisen Bank, me shkresën nr. 3***, datë 19.10.2018 konfirmon se z. F. L ka gjendje llogarie 363 lekë dhe 26 euro. F. L ka qenë kredimarrës në tre raste:

a. kredi e marrë në datë 19.12.2007, në shumën 700 000 lekë, kredi e mbyllur më datë 27.03.2009;

b. kredi e marrë më datë 27.03.2009, në shumën 57 900 lekë dhe mbyllur më datë 27.03.2016;

c. kredi e marrë më datë 15.02.2011 në shumën 57 900 lekë dhe e mbyllur më datë 15.02.2013;

Për të dhënat e tjera në këtë denoncim, Komisioni nuk arriti në ndonjë rezultat.

Në lidhje me këtë subjektit iu kalua barra e provës, për të shpjeguar pozicionin e tij.

Në shpjegimet e tij me shkrim, subjekti ka sqaruar se nuk ka lidhje me këto pasuri, ato janë vetëm pasuri të shtetasit F. L. Subjekti megjithatë ka dhënë shpjegime, të cilat “*po i jap kundër dëshirës sime që një letër anonime vihet në lëvizje duke më krijuar një emocion mua dhe vajzës sime*”, - pretendon subjekti.

Subjekti, duke shoqëruar shpjegimet e tij edhe me dokumentacion, ka pretenduar të provojë se:

- apartamenti me sipërfaqe 150m² është përfituar nga shtetasi F.L. në vitin 1996, si i pastrehë, meqënëse ishte me statusin e ushtarakut.
- njësi me sipërfaqe 296 m², e ka blerë në vitin 2013 në një ankand publik, dhe për këtë ka paguar vetëm shumën 230, 000 lekë, kurse diferencën prej 5, 270.000 lekë që të plotësohej vlera 5,500.000 sa kushtonte ½ pjesë e tij, për blerjen e objektit e ka marrë me kontratën e huas 27.02.2017 me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., të kaluar nëpërmjet llogarisë bankare nga shtetasi A. Sh.
- ndërsa për godinë banimi 2 kate me sipërfaqe trualli 158.5 m². dhe sipërfaqe ndërtimi 108.5m², subjekti ka shpjeguar se: “*Prona në fjalë është produkt i punës së tij ndër vite, nga vendimi i KRRT-së nr. ***, datë 01.06.1998 të Rrethit Sarandë (konkretisht, të drejtën për dhënie shesh ndërtimi 323 m²) të vendimit nr. ***, datë 25.06.1999 të KRRT Rrethit Sarandë me të cilin i është dhënë leja e ndërtimit, kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.08.2000 me Këshillin e Rrethit Sarandë, ndërtimi i karabinasë sipas lejes së sipërfaqeërcituar, te mbyllja gradualisht e katit të parë deri në vitin 2010, te deklarimi në procesin e legalizimit në datën 18.07.2013 për të formalizuar objektin, pasi kishte kryer punime përtej afatit të lejes së ndërtimit të vitit 1999, te legalizmi i objektit në vitin 2017, te pjesëtimi me bashkëpronarin K. Xh (baxhanaku) dhe deri në regjistrimin final të pjesës së vetë takuese me nr.pasurie 3/155, sipërfaqe trualli 158.5 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 108.5 m² në emër të F. L.*”

Në seancë subjekti pretendoi se: “*Vajza ime është lidhur me dhëndrin nga viti 2012 mesa me kujtohet, fejesa dhe dy pasuritë i ka pasur kur vajza ishte 6 vjeç dhe 8 vjeç.*”

Pasi shqyrtoi shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti, e dëgjoji atë në seancë, Komisioni konstaton se këto shpjegime nuk janë aspak bindëse. Nisur nga të dhënat e administruara nga bankat e nivelit të dytë rezulton se gjendja financiare ndër vite e shtetasit F.L. nuk mundëson krijimin e këtyre pasurive. Nga ana tjetër subjekti ka qenë kontradiktor në deklaratimet e tij në seancë. Ai pretendon se njohja me shtetasin F.L. ka ardhur si pasojë e lidhjes së fëmijëve të tyre në vitin 2012. Pyetjes së relatores në seancë se si ka mundësi që brenda një viti njohjeje familjare, shtetasi F.L. i ka dhënë subjektit huan prej 3, 500. 000 lekë pa interes, subjekti iu përgjigj se: “*Në momentin që u kurorëzua lidhja, atëherë erdhën fëmijët me studime në Tiranë. Çfarë do të bëjmë? Do të blejmë një shtëpi që mos të rrinin me qira. Ai vuri pjesën e tij dhe shtëpia kaloi në emrin tim....[...] ... u detyruam të blinim më mirë një shtëpi apo të rrinin me qira. Ato lekët e qirasë i jepnim me kredi dhe kjo është e gjitha. Ne ramë dakord. Nuk e blemë në bashkëpronësi me krushkun. Më tha merre ti dhe kur t'i kesh m'i jep, domethënë marrëdhënie miqësie. Kjo është e gjitha.*”

Por Komisioni konstaton se, së bashku me dokumentat provues për deklaratën “Vetting”, subjekti ka depozituar, përveç kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.02.2013, edhe një deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.10.2016, të shtetasit F.L., i cili deklaroi se shumë prej 3, 500. 000 lekë ia ka dhënë subjektit hua për shkak të miqësisë familjare që kam me të prej vitesh. Kjo deklaratë e shtetasit F.L. përpara noterit publik është krejtësisht e ndryshme nga deklarata e subjektit përpara Komisionit, duke e vënë këtë të fundit në kushtet e deklaratimit të rremë.

Gjithashtu nuk është bindës edhe argumenti i subjektit se me huan e marrë nga krushku ka blerë një apartament në Tiranë për të jetuar fëmijët e tij së bashku me dhëndrin dhe e ka regjistruar këtë shtëpi në emër të tij, duke përjashtuar nga regjistrimi huadhënësin, djali i të cilit ishte një nga banorët e këtij apartamenti.

8. Denoncim anonim

Komisioni hetoi edhe mbi këtë denoncim, megjithëse anonim. Rezultoi se jo të gjitha pikat e denoncimit mund të verifikohen. Sipas denoncuesit:

- a. Subjekti ka dy apartamente banimi në pallatin e Ç. Z, afër Gjykatës në Sarandë, ku njëjën e ka mobiluar për zyrë avokatie.

Në lidhje me këtë rezulton se bëhet fjalë për ambient 30 m² të deklaruar nga subjekti. Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të printuar nga faqja zyrtare e QKB-së, rezulton se dhëndri i subjektit, A. L dhe M. N me të cilin kanë patur në bashkëpronësi njësinë prej 102 m², kanë të njëjtën adresë të ushtrimit të profesionit të avokatit me adresën e deklaruar nga subjekti për ambient 30 m².

Nga ana tjetër, siç është konstatuar edhe në pikën 6, në faqen 17 të këtij relacioni, ndërtuesi i kësaj godine, Ç. Z ka qenë palë ndërgjyqëse në çështjen nr. ***, me datë regjistrimi 29.06.2010, me gjyqtar subjektin Çela.

Në lidhje me këtë subjektin iu kalua barra e provës, për të shpjeguar pozicionin e tij.

Subjekti ka mohuar të ketë dy apartamente banimi në këtë pallat. Ai ka shpjeguar se në këtë pallat ka në posedim vetëm ambientin 30 m² në katin e ***, të deklaruar në deklaratën “Vetting” 2017, i cili është shqyrtuar nga Komisioni më sipër. Subjekti gjithashtu pretendoi se: *“Dhëndri A. L. nuk ka pasur dhe nuk ka zyrë avokatie në qytetin e Sarandës dhe aq më pak në këtë objekt. Ai është i punësuar me kontratë pranë fondacionit “S.” dhe profesionin e avokatit e ushtron jashtë orarit të përcaktuar në kontratë. ..., ai ka vënë si adresë pallati pranë gjykatës, adresë tek av.L. Z., ku ka kryer praktikën si asistent”*.

Gjatë shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të sjella nga subjekti, duke i krahasuar ato me të dhënat që ndodhen në faqe zyrtare të QKB-së, konstatoi se shtetasi A.L., dhëndri i subjektit, ka deklaruar si vend të ushtrimit të aktivitetit si avokat, me NIPT ***, adresën lagja nr. ***, rruga “****”, pallati ***, kati ***, Sarandë. Ndërsa adresa e pretenduar nga subjekti, që pasqyrohet në ekstraktin e avokatit L.Z., që gjendet në faqen zyrtare të QKB-së, është rruga “****”, godina ***, kati ***, Sarandë.

Komisioni vlerëson se mund të jetë e vërtetë që subjekti nuk ka dy apartamente në këtë pallat sipas denoncimit, por shpjegimet e paraqitura me shkrim nuk kanë qenë të vërteta. Subjekti ka kryer deklaram të rremë përpara Komisionit.

- b. Ndër të tjera, denoncuesi ka pretenduar se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, duke u shprehur me vendim në lidhje me pronat e shtetasit H. Ç, tek i cili ka shkuar për pushime në Kanada për një periudhë dyjavore. Bashkëlidhur denoncimit gjenden dhe foto.

Komisioni hetoi gjerësisht mbi këto fakte. Nga ky hetim rezulton se subjekti Alltun Çela është shprehur disa herë me vendim në favor të shtetasit Ç. dhe motrës së tij, S. I (Ç.), duke filluar që nga dëshmia e trashëgimisë e lëshuar me vendim nr. ***, datë 26.06.2012. Më tej Komisioni administroi nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë:

- Vendim nr. ***, datë 04.04.2012, vendim i shprehur në favor të shtetases S. I (Ç.), me kryesues të trupit gjykues subjektin. Në përfundim gjykata ka vendosur ndër të tjera, njohjen e së drejtës së pronësisë në Ksamil, për trashëgimtarët ligjore të H. Ç;
- Vendim nr. ***, datë 28.09.2000, me objekt vërtetimin e faktit juridik të ish-pronësisë së H. Ç në Ksamil, kryesues i trupit gjykues subjekti, shprehur në favor të kërkuesit M. Sh, trashëgimtar ligjor i H. Ç;

Nëpërmjet faqes zyrtare të Gjykatës Sarandë u administruan:

- Vendim nr. ***, datë 6.5.2013, kërkuese S. I, gjyqtar Allutn Çela;
- Vendim nr. ***, datë 25.04.2014, paditëse S. I, gjyqtar Alltun Çela (me trup gjykues);
- Vendim nr. ***, datë 06.03.2015, palë paditëse S. I, gjyqtar Alltun Çela (me trup gjykues).

Komisioni konstaton se S. I (Ç.) vepron edhe në emër të vëllait, H. Ç. Nga ballafaqimi i fakteve si më poshtë:

- Në pyetësorin tip, subjekti ka deklaruar pushime në Kanada 12.08.2015-24.08.2015;
- Subjekti është shprehur me vendim në favor të H. Ç në muajin mars të vitit 2015;
- Nga fotot e bashkëlidhura denoncimit dhe krahasimi i tyre me fotot e tjera në faqen *facebook* të subjektit, bashkëshortes së tij dhe bashkëshortes së z. H. Ç;
- Komunikimi në rrjetin social *facebook* me z. H. Ç,

rezulton se:

- subjekti ka marrëdhënie miqësore e familjare me palën ndërgjyqëse H. Ç, që duket qartë nga fotot dhe komunikimi në rrjetin social *facebook*.

Në lidhje me këtë subjektin iu kalua barra e provës, për të shpjeguar pozicionin e tij.

Subjekti ka mohuar të ketë njohje personale më parë me z. H.Ç., pasi ai jeton në Kanada. Ai pretendon se takimi i këtij shtetasi në Kanada ka qenë i rastësishëm. Subjekti ka shpjeguar ndër të tjera, se: *“Emri i këtij shtetasi për mua ishte disi i njohur për shkak të proceseve gjyqësore, që janë zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Këtë shtetas, unë e kam takuar personalisht për herë të parë në Kanada kur kam qenë për vizitë. Gjatë bisedës jemi njohur si patriotë pasi dhe ai është nga Delvina, por ka qenë i larguar prej shumë kohësh. Theksoj se në kohën që unë jam takuar me këtë shtetas, pra në muajin gusht 2015, nuk kam pasur asnjë çështje gjyqësore në proces, saktësoj që prej disa muajsh. Nga dita që jam takuar rastësisht në Kanada, unë nuk kam bërë asnjë proces tjetër gjyqësor dhe as jam takuar më pas asaj kohe me atë shtetas...[...]... Në rast se unë do të gjykoja çështje pas takimit me shtetasin H. Ç, mund të kisha pengesë ligjore sipas nenit 72 të K.Pr.Civile.”*

Madje edhe komentet e z. H.Ç në faqen e rrjetit social *facebook* të subjektit, ai nuk i konsideron si njohje ndërpersonale të ngushtë, si dhe nuk përbënte shkak për heqje dorë nga gjykimet. Në seancë subjekti deklaroi se: *“Nuk kishim njohje të mëparshme, thjesht nëpërmjet gjykimeve.”*

Pasi shqyrtoi provat dhe shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë rezultat të hetimit, Komisioni nuk krijon bindje për çfarë subjekti pretendon, për njohje rastësore me z. H.Ç.

Komentet e z. H.Ç vërtet nuk tregojnë afërsi personale, por tregojnë që kanë njohje të mjaftueshme dhe jorastësore, pasi këto komente janë të shtrira në kohë dhe për raste të ndryshme, madje në njërin nga komentet, në tetor 2012, z. H.Ç. e uron subjektin *“Qoftë edhe viti i rikonfirmimit tënd në krye të gjykatës së Sarandës!”*

Duke patur parasysh numrin e çështjeve gjyqësore të këtij shtetasi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë në periudhën 2012-2015, si dhe faktin që subjekti ka marrë pjesë në këto gjykime, Komisioni vlerëson se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, qoftë edhe në dukje, duke cenuar rëndë etikën dhe figurën e gjyqtarit.

v. Komisioni konstatoi:

Nga vëzhgimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konstatohet se vendimet e dhëna nga subjekti, në ekstraktin e publikuar në faqe rezultojnë në emër të A. Ç.

Disa prej këtyre vendimeve janë:

- Vendimi nr. ***, datë 15.09.2014;
- Vendim nr. ***, datë 03.06.2015;
- Vendim nr. ***, datë 30.01.2013;
- Vendim nr. ***, datë 04.04.2012;
- Çështja civile nr. ***, datë regjistrimi 30.10.2018 (statusi: në përpunim);
- Çështja civile nr. ***, datë regjistrimi 23.10.2018 (statusi: në përpunim);

Ndërsa vendimet e gjyqtarëve të tjerë shfaqen me emrin e gjyqtarit përkatës.

I pyetur për këtë fakt subjekti ka shpjeguar në përgjigjen e tij të datës 06.11.2018, se, pasi ka kontaktuar me personin përgjegjës IT të Gjykatës, portali i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë herë pas here shfaq probleme në lidhje me dublimin e të dhënave.

Në lidhje me këtë subjektin iu kalua barra e provës për të shpjeguar pozicionin e tij.

Subjekti sqaroi se kishte marrë djeni për këtë fakt vetëm pas dërgimit të pyetësorit nga ana jonë, më datë 31.10.2018. Ai pretendoi se kishte marrë masa duke kërkuar shpjegime tek specialisti IT i gjykatës dhe tek kompania që administron sistemin. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti depozitoi si provë komunikimin shkresor të mësipërme.

Komisioni konstaton se, me cilësinë e kryetarit të gjykatës, subjekti nuk ka treguar vëmendje dhe kujdes për sistemin elektronik që pasqyron aktivitetin gjyqësor të këtij institucioni, duke sjellë kështu mungesë të transparencës dhe disinformim të publikut. Nga ana tjetër, subjekti nuk shpjegoi përse ky problem shfaqet vetëm me çështjet e gjykuara prej tij dhe jo për gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, pasi shqyrtoi raportin e vlerësimit profesional të hartuar nga KLD-ja dhe denoncimet nga publiku, Komisioni çmon se subjekti ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim nën nivelin mesatar dhe nuk është efektiv. Komisioni konstaton se subjekti, në mënyrë të përsëritur ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit. Në dosjet gjyqësore të shqyrtuara si rezultat i denoncimeve nga publiku, si dhe dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore me short, konstatohen mangësi të theksuara në arsyetimin ligjor, në parashtrimin e fakteve dhe përdorimin e doktrinës juridike.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, i cili deklaroi në seancë se është dakord me të gjitha gjetjet e bëra nga Komisioni, të cilat kanë qenë korrekte dhe ligjore dhe kërkoi konfirmimin në detyrë, mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej tij, trupi gjykues konkludon se:

- subjekti ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë;
- subjekti rezultoi i papërshtatshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës;
- subjekti ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët dhe nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trainimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

Duke kryer një vlerësim tërësor të të tre kriterëve mbi të cilat mbështetet procesi i rivlerësimit të gjyqtarit, Komisioni konkludon gjithashtu se, subjekti i rivlerësimit Alltun Çela, me veprimet/mosveprimet e tij, ka cenuar rëndë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të pikës 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit e rivlerësimit, z. Alltun Çela.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 08.01.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

PAMELA QIRKO

Kryesuese

XHENSILA PINE

Anëtare

GENTA Tafa (BUNGO)

Relatore

ANISA DUKA

Sekretare gjyqësore